



USHTRIA



Viti i 75-të i botimit Nr. 16 (827768)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 22 Prill 2022

Gjeneralmajor Begaj pret komandantin e Forcave të Mbështetjes Logjistike të FA të Austrisë, gjeneralmajor Andreas Pernsteiner

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj priti në një takim kortezie, komandantin e Forcave të Mbështetjes Logjistike të FA të Austrisë, gjeneralmajor Andreas Pernsteiner, si dhe komandantin e Shkollës Logjistike gjeneral brigade Stefan Lampl. Në fjalën e tij, gjeneralmajor Begaj vlerësoi rolin dhe angazhimin e Forcave të Armatosura të Austrisë në bash-

këpunimin dypalësh në fushën e mbrojtjes, sikundër vlerësoi shumë të rëndësishme dhe në interes për FARSH në të ardhmen, asistencën e Shkollës Logjistike austriake për kurse dhe trajnime profesionale të ndryshme në specialitetet transport dhe furnizim, kërkim-shpëtim, EOD dhe siguri fizike të menaxhimit të stoqeve. "Gjithashtu, në kuadër të ristrukturimit të emergjencave civile ndihma ushtarake për këto njësi

do të ishte mjaft e rëndësishme", -u shpreh ndër të tjera gjatë takimit gjeneralmajor Begaj. Nga ana e tij, gjeneralmajor Pernsteiner, pasi falënderoi gjeneralmajor Begaj për pritjen e ngrohtë, vlerësoi rolin e Shqipërisë për kontributin e saj në Aleancë dhe në sigurinë rajonale, si dhe shprehu mbështetjen e tij për rritjen më tej të bashkëpunimit dypalësh në fushën e mbrojtjes midis dy vendeve... » faqe 2



Bashkëpunimi

Ministria e Mbrojtjes, dhjetë milionë dollarë për Emergjencat Civile



» faqe 3

"Unë vrapoj për një Hero! Heroi im është një grua!"

"NATO Run, Tirana 2022", solli sërish edhe këtë vit, vrapimin sensibilizues me kauzën "Unë vrapoj për një Hero! Heroi im është një grua!". Kjo kauzë simbolizon rolin e vlerave transatlantike dhe kontributit të të gjithë heronjve tanë.

Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të RSH iu bashkuan edhe sot kësaj nisme duke kontribuar me shumë pjesëmarrës dhe tre fitues...



» faqe 2

Ceremonia e 100-vjetorit të lindjes së gjeneral Muhamet Prodanit

Me rastin e 100-vjetorit të lindjes së gjeneral Muhamet Prodanit, në ambientet e "Tirana International Hotel", miq, të afërm, zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, deputetë dhe bashkudhëtarë të tij në vite, u mbledhën për të kujtuar në këtë 100-vjetor figurën dhe kontributin e tij. Mes të tjerash gjeneralmajor Shehu do të transmetonte dhe vlerësimet maksimale ndaj kësaj figure të rëndësishme ushtarake, me vlera të spikatura patriotike dhe atdhetare në emër të Ministrit të



» faqe 5

Përfundon Kursi i 50-të i Avancuar i Nënoficerit në QAPN

Në ambientet e Qendrës së Arsimit Profesional të Nënoficerëve u zhvillua ceremonia e certifikimit të kursantëve të kursit 50-të të Avancuar të Nënoficerit. Në këtë ceremoni morën pjesë Komandanti i QAPN-së Kolonel Arben Toska, si dhe stafi i instruktorëve të QAPN-së. Në fjalën e tij përshëndetëse Komandanti i QAPN-së Kolonel Toska duke iu drejtuar kursantëve që u certifikuan theksoi se: "Konkretisht ne sapo kemi përfunduar rishikimin e të gjithë programeve mësimore, kurrikulave, si dhe aktualisht jemi të angazhuar maksimalisht në rishikimin e dispencave, për t'i ardhur sa më pranë...



» faqe 3



Nisma



“Unë vrapoj për një Hero! Heroi im është një grua!”

“NATO Run, Tirana 2022”, solli sërish edhe këtë vit, vrapimin sensibilizues me kauzën “Unë vrapoj për një Hero! Heroi im është një grua!”. Kjo kauzë simbolizon rolin e vlerave transatlantike dhe kontributit të të gjithë heronjve tanë.

Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të RSH iu bashkuan edhe sot kësaj nisme duke kontribuar me shumë pjesëmarrës dhe tre fitues.



BASHKËPUNIMI

Ministria e Mbrojtjes, dhjetë milionë dollarë për Emergjencat Civile

Njësitë e vetëqeverisjes vendore do të kenë më shumë burime financiare për të përballuar emergjencat civile në territorin e tyre.

Në bazë të ligjit 45/2019, “Për Mbrojtjen Civile” dhe buxhetit të vitit 2022, Ministria e Mbrojtjes u ka akorduar bashkive një fond total prej 10 milionë dollarë. Ky fond u është shpërndarë të 61 bashkive të Republikës së Shqipërisë, bazuar në peshën specifike që zë buxheti i çdo bashkie ndaj totalit të buxhetit të të gjitha bashkive. Fondi ndihmon bashkitë në përmbushjen e detyrimeve të tyre në kuadër të reduktimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile.

Megjithatë, ky është vetëm fondi që u akordohet bashkive nga Buxheti i Shtetit, pasi sipas ligjit 45/2019 njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të planifikojnë fonde të tjera shtesë nga të ardhurat e veta vendore, nga fondet që u vijnë drejtpërdrejt nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacionet etj.



PLANIFIKIMI

Ky është vetëm fondi që u akordohet bashkive nga Buxheti i Shtetit, pasi sipas ligjit 45/2019 njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të planifikojnë fonde të tjera shtesë nga të ardhurat e veta vendore, nga fondet që u vijnë drejtpërdrejt nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacionet etj.

Takimi

Gjeneralmajor Begaj pret komandantin e Forcave të Mbështetjes Logjistike të FA të Austrisë, gjeneralmajor Andreas Pernsteiner

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj priti në një takim kortezie, komandantin e Forcave të Mbështetjes Logjistike të FA të Austrisë, gjeneralmajor Andreas Pernsteiner, si dhe komandantin e Shkollës Logjistike gjeneral brigade Stefan Lampl.

Në fjalën e tij, gjeneralmajor Begaj vlerësoi rolin dhe angazhimin e Forcave të Armatosura të Austrisë në bashkëpunimin dypalësh në fushën e mbrojtjes, sikundër vlerësoi shumë të rëndësishme dhe në interes për FARSH në të ardhmen, asistencën e Shkollës Logjistike austriake për kurse dhe trajnime profesionale të ndryshme në specialitetet transport dhe furnizim, kërkim-shpëtim, EOD dhe siguri fizike të menaxhimit të stoqeve. “Gjithashtu, në kuadër të ristrukturimit të emergjencave civile ndihma ushtarake për këto njësi do të ishte mjaft e rëndësishme”, -u shpreh ndër të tjera gjatë takimit gjeneralmajor Begaj.

Nga ana e tij, gjeneralmajor Pernsteiner, pasi falënderoi gjeneralmajor Begaj për pritjen e ngrohtë, vlerësoi rolin e Shqipërisë për kontributin e saj në Aleancë dhe në sigurinë rajonale, si dhe shprehu mbështetjen e tij për rritjen më tej të bashkëpunimin dypalësh në fushën e mbrojtjes midis dy vendeve tona.

Vizita e komandantit të Forcave të Mbështetjes Logjistike të FA të Austrisë në Shqipëri përfshin takim pune në Komandën Mbështetëse dhe në Qendrën Stërvitore të KM, ku do të njihet më nga afër me kapacitetet dhe aktivitetet e tyre.



SHEFI I SHTABIT

Gjeneralmajor Begaj vlerësoi rolin dhe angazhimin e Forcave të Armatosura të Austrisë në bashkëpunimin dypalësh në fushën e mbrojtjes, sikundër vlerësoi shumë të rëndësishme dhe në interes për FARSH në të ardhmen, asistencën e Shkollës Logjistike austriake për kurse dhe trajnime profesionale të ndryshme në specialitetet transport dhe furnizim, kërkim-shpëtim, EOD dhe siguri fizike të menaxhimit të stoqeve.



Arsimimi

Në ambientet e Qendrës së Arsimit Profesional të Nënoficerëve u zhvillua ceremonia e certifikimit të kursantëve të kursit 50-të të Avancuar të Nënoficerit.

Në këtë ceremoni morën pjesë Komandanti i QAPN-së Kolonel Arben Toska, si dhe stafi i instruktorëve të QAPN-së.

Në fjalën e tij përshëndetëse Komandanti i QAPN-së Kolonel Toska duke iu drejtuar kursantëve që u certifikuan theksoi se: “Konkretisht ne sapo kemi përfunduar rishikimin e të gjithë programeve mësimore, kurrikulave, si dhe aktualisht jemi të angazhuar maksimalisht në rishikimin e dispencave, për t'i ardhur sa më pranë qasjeve dhe nevojave që ka trupa e nënoficerëve në fushën e arsimit dhe trajnimit”.

Kolonel Toska më tej ritheksoi rëndësinë e intensifikimit të

Përfundon Kursi i 50-të i Avancuar i Nënoficerit në QAPN



bashkëpunimit në kuadër të NATO-s e në mënyrë të veçantë bashkëpunimin tashmë të institucionalizuar e konstant me Gardën Kombëtare të “New Jersey”, SHBA, bashkëpunim që u materializua pak ditë më

parë me vizitën e ekipit të Gardës në QAPN. Në përfundim të kësaj ceremonie u shpërndan certifikatat për 37 kursantë, dy prej tyre personel femër të ardhur nga struktura të ndryshme të FA-së.



Ekipi austriak vizitë në Komandën Mbështetëse dhe Qendrën Stërvitore

Në kuadër të planit të bashkëpunimit dypalësh, një delegacion ushtarak austriak i përbërë nga gjeneralmajor Andreas Persteiner komandanti i Forcave të Mbështetjes Logjistike të FA të Austrisë, si dhe gjeneral brigade Stefan Lampl komandanti i Shkollës Logjistike të FA të Austrisë, u prit në një takim nga komandanti i Komandës Mbështetëse gjeneral brigade Ilir Xhebexhia dhe shtabi i KM, ku u mbajt brifing njohës nga të dyja palët.

Qëllimi i kësaj vizite ishte njohja më nga afër me misionin, rolin e Komandës Mbështetëse në Forcat e Armatosura si dhe rritjen e bashkëpunimit midis dy shteteve. Gjatë takimit, dyditor ushtarakët e dy vendeve evidentuan fushat më të rëndësishme: intensifikimi dhe bashkëpunimi mes Qendrës Stërvitore të Komandës Mbështetëse me atë të Shkollës Logjistike austriake, që nga arsimimi e trajnimi i ushtarakëve shqiptarë në fushën e logjistikës, mbështetjen konkrete me materiale teknike dhe deri tek stërvitjet e përbashkëta midis dy vendeve.

Komandanti i Komandës Mbështetëse duke vlerësuar vizitën e gjeneralmajor Persteiner si dhe gjeneral brigade Lampl, shprehu në të njëjtën kohë edhe besimin e tij se bashkëpunimi dypalësh do të bëhet edhe më i ngushtë edhe më i frytshëm, sidomos në fushën e trajnimit dhe edukimit të ushtarakëve të Komandës Mbështetëse në fushën e Logjistikës.

Nga ana e tij, gjeneralmajor Persteiner shprehu bindjen se fusha të reja bashkëpunimi do të hapen mes dy vendeve në të ardhmen dhe se marrëdhëniet do të thellohen më tej, bashkëpunimi ushtarak ndërmjet dy vendeve tona do të vazhdojë të jetë në nivele të larta si dhe do të njohë rritje në të gjitha fushat me



interes reciprok. Më tej takimi vijoi në ambientet e Qendrës Stërvitore të Komandës Mbështetëse, ku komandanti i

kësaj qendre kolonel Ylli Zylaj kishte përgatitur një brifing njohës për të pranishmit. Në përfundim të takimit u



shkëmbyen dhuratat reciproke dhe të dy palët shprehën gatishmërinë për vazhdimin dhe thellimin e këtij bashkëpunimi edhe në të ardhmen.

XHENIERËT

Specialistët EOD eliminojnë rrezikun e municioneve të gjetura në Vlorë

Specialistët xhenierë të grupit SEOD, ditën e djeshme pas sinjalizimit për gjetje municionesh të paplasura në njësinë administrative Kërkovë, bashkia Vlorë, janë nisur menjëherë në vendngjarje dhe pas kryerjes së vlerësimit të rastit ndoqën procedurat për mënjanimin e



rrezikut të disa municioneve luftarake, të cilat u vlerësuan si të prekshme e të lëvizshme.

Këto municione u transportuan dhe u magazinuan në depot e Batalionit të Xhenios për asgjësim në një moment të dytë. Komanda Mbështetëse ka dhënë kontribut të konsiderueshëm në vite, jo vetëm në shërbim të misionit të Forcave të Armatosura për pastrimin e asgjësimit të municioneve të paplasura në poligonet ushtarake, por edhe në shërbim të komunitetit.

Vizita

FORCA AJRORE



Fëmijët treguan interes dhe kuriozitet jo vetëm për helikopterët dhe mjetet mbështetëse si zjarrfikëset, por edhe për profesionin e pilotit.

Fëmijët e kopshtit 24 të qytetit të Tiranës, vizitë në Bazën Ajrore Farkë

Mjediset e Bazës Ajrore Farkë gumëzhinë nga zërat e gëzueshëm të fëmijëve të kopshtit 24 të qytetit të Tiranës. Ata u mirëpritën nga personeli i Bazës Ajrore Farkë dhe Forcës Ajrore.

Vizita e tyre kishte qëllim njohjen e fëmijëve me mjetet fluturuese, por edhe me profesionin e pilotit si edhe me teknikët e Forcës Ajrore.

Piloti Marsel Xhameni u bë personazhi i ditës së sotme duke shoqëruar fëmijët dhe edukatorët e drejtuesen e kopshtit 24, në mjediset e Bazës Ajrore Farkë si dhe duke i njohur ata nga afër me helikopterët dhe mjetet ajrore të bazës.

Gjatë turit, fëmijët treguan interes dhe kuriozitet jo vetëm për helikopterët dhe mjetet mbështetëse si zjarrfikëset, por edhe për profesionin e pilotit, dëshirë të cilën disa prej tyre vajza dhe djem e shprehën me entuziazëm dhe kërshëri si zgjedhje për të ardhmen e tyre.



Ceremonia e 100-vjetorit të lindjes së gjeneral Muhamet Prodanit

Me rastin e 100-vjetorit të lindjes së gjeneral Muhamet Prodanit, në ambientet e “Tirana International Hotel”, miq, të afërm, zëvendëssefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, deputetë dhe bashkudhëtarë të tij në vite, u mblodhën për të kujtuar në këtë 100-vjetor figurën dhe kontributin e tij. Mes të tjerash gjeneralmajor Shehu do të transmetonte dhe vlerësimet maksimale ndaj kësaj figure të rëndësishme ushtarake, me vlera të spikatura patriotike dhe atdhetare në emër të Ministrit të Mbrojtjes z. Niko Peleshi dhe shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Bajram Begaj.

Më tej gjeneralmajor Shehu do shprehej:

“Është kënaqësi e veçantë për mua si zëvendëssefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, por edhe si gjeneralmajor, të marr pjesë në këtë aktivitet shumë kuptimplotë dhe të rëndësishëm, në kujtim të 100-vjetorit të lindjes, të një Gjenerali lufte e një Heroi Populli, siç është Gjenerallejtnant Muhamet Prodan, me një kontribut të jashtëzakonshëm gjatë luftës nacionalçlirimtare dhe më vonë në drejtimin e formacioneve të rëndësishme të Forcave të Armatosura për ruajtjen



Gjeneral Prodan kishte aftësi shumë të mira drejtuese e organizuese, prandaj pak kohë përpara se të zhvillonte punimet Kongresi i Përmetit, e emëruan në detyrën e Komandantit të Brigadës së Parë Sulmuese e më pas, në atë të Komandantit të Divizionit të III.

Në të gjitha betejat luftarake, që mori pjesë, tregoi aftësitë e tij të padiskutueshme të një lidërshpi ushtarak. Si rrallëkush aftësitë e tij

shkëlqyen në luftën për Çlirimin e Tiranës, ku në qendër të formacioneve që morën pjesë në këtë betejë heroike, ishte Brigada e I, dhe në krye të saj ishte komandanti legjendar, Muhamet Prodan, ashtu siç do të merrte pjesë edhe në betejat të tjera, përfshi edhe atë për çlirimin e Dibrës, etj.

Mbas çlirimit të vendit, gjeneral Prodan, kreu një sërë kualifikimesh brenda e jashtë vendit, të cilat e formuan si një ushtarak e lider i vërtetë

e duke kryer me sukses mjaft detyra të rëndësishme për modernizimin e ushtrisë të dalë nga lufta, për

njihte ai, por edhe një drejtues më tërë cilësitë që duhet të ketë një drejtues i mirë ushtarak, por pas daljes në pension edhe të një aktivisti të rrallë të Organizatës së Veteranëve të Luftës antifashiste Nacionalçlirimtare.

Përveçse një ushtarak i zoti e i rrallë, gjeneral Prodan ishte një bashkëshort i denjë për Manushaqe Prodanin, një prind dhe baba shembullor i 4 djemve, Shpëtim, Shkëlqimit, Fatmirit dhe Arjanit dhe një gjysh i shkëlqyer i nipërve dhe mbesave të tij.

Gjenerallejtnant Muhamet Prodan u nda nga jeta më 11 tetor 1997, duke lënë një histori të lavdishme të tij e duke mos ia zbehur aspak edhe periudha e diktaturës, e cila e burgosi, e internoi bashkë me familjen, por asnjëherë nuk e mposhti nga mendimet dhe lavdia e tij e fituar me gjak, djersë dhe stërmundim për vete dhe familjen e tij.

Le të jetë ky përvjetor i njëqind, një homazh dhe një memorial i veprës së tij të lavdishme, të cilën në ushtara-



përsosjen e formacioneve ushtarake dhe fuqizimin e aftësisë mbrojtëse të vendit, si komanduese, deri Komandant i Korpusit të Gjirokastrës, ashtu edhe në shtabe, deri në Shtabin Përgjithshëm të FA-së, në detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Kufirit, Drejtorit të Drejtorisë Operative e të Përgatitjes Luftarake, ku spikatën aftësitë e tij drejtuese, organizuese, por edhe njerëzore. Gjeneral Muhamet Prodan ishte shembulli i një ushtaraku të mirëfilltë, i një ushtaraku që duhet të njohë me hollësi terrenin në çdo cep të Shqipërisë ashtu siç e

kët e sotëm duhet ta ndjekim dhe t’ua mësojmë brezave të rinj.

Përulëmi me respekt përpara aftësive të tij drejtuese dhe komanduese, përpara këtij njeriu që lavdinë e fitoi me cilësitë e rralla që kishte, përpara të gjithë njerëzve të kësaj kategorie që janë pjesë e memories historike të Kombit tonë.

Ju bijtë e Tij, nipër e mbesa, vendlindja Kolonja, por edhe ne, Forcat e Armatosura, duhet të ndihemi krenarë për këtë figurë të rëndësishme, ushtarake, shoqërore dhe njerëzore që bëri emër në histori.”



dhe fuqizimin e aftësisë mbrojtëse të vendit.

Gjeneral Prodan u lind më 9 prill 1922 në një krahinë patriotike, siç është Kolonja, por edhe në një familje me tradita po të tilla.

Gjeneral Prodan i përket atij brezi të artë patriotësh shqiptarë, që iu bashkuan lëvizjes nacionalçlirimtare që në hapat e para dhe dhanë kontribut të rëndësishëm në çlirimin e vendit nga pushtuesit e huaj.

Ai e filloi karrierën e tij të luftës si luftëtar i thjeshtë, si antifashist i tërbuar e si atdhetar i flaktë qysh në vitet e adoleshencës, për të vazhduar në atë të Komandantit të Njësitit në Çetën e Kolonjës, të Komandantit të Kompanisë në Batalionin “Hakmarrja”, për të vazhduar më tej në detyrën e Komandantit të Kompanisë e të Batalionit në Brigadën e Parë Sulmuese.

Vizita

Në ambientet e sallës së konferencave të Forcës Tokësore, u realizua konferenca kryesore planëzuese e stërvitjes “Biza-22”.

Aktiviteti u hap nga zëvendëskomandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Ferdinand Dima. Në përshëndetjen e tij drejtuar të pranishmëve, gjeneral brigade Dima e vlerësoi këtë konferencë si moment tepër i rëndësishëm i përgatitjeve për angazhimin më të madh të këtij viti, jo vetëm të Forcës Tokësore, por edhe të Forcave të Armatosura siç është certifikimi i Grup-Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë (GBKL). Nisur nga kjo, gjeneral brigade Dima kërkoi nga të gjithë pjesëmarrësit në konferencë, përkushtim maksimal gjatë gjithë periudhës së zhvillimit të saj.

Konferenca, u përshëndet



gjithashtu në emër të Shtabit të Përgjithshëm nga drejtori i Drejtorisë së Operacioneve dhe Stërvitjes kolonel Beqir Tafili. Ai, përgëzoi organizatorët e këtij aktiviteti, për masat e marra për zhvillimin sa më normal të



konferencës si dhe kërkoi që i gjithë personeli i angazhuar në të, të tregojë profesionalizmin që i karakterizon, për të arritur në fund me një produkt cilësor, që do të ndikojë në certifikimin e Grup-Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë nga

grupi i vlerësimit të NATO-s.

Konferenca kryesore planëzuese e “Biza-22”, është një nga tre konferencat që zhvillohet në interes të përgatitjeve për zhvillimin e stërvitjes me të njëjtin emër, në muajin shtator të këtij viti.

Forca Tokësore mban konferencën planëzuese “Biza-22”

Studentët e FA-së vizitojnë "West Point"

INTERVISTOI
ANJEZA MUSOLLARI

Arritja e përsosmërisë në sistemin arsimor është mjeti më i rëndësishëm i suksesit tonë të ardhshëm.

Të zgjedhësh një model arsimimi nuk është vetëm mundësi, por dhe përgjegjësi. Vlera e një modeli është në proporcion të drejtë me faktin se sa mirë korrespondon me të shkuarën, të tashmen, të ardhmen, nivelin aktual apo potencial të mundësive dhe prespektivës. Ndaj Qeveria Shqiptare, Ministria e Mbrojtjes dhe FA po implementojnë në sistemin tonë arsimor ushtarak, sistemin e Akademisë Ushtarake të "West Point", ku vizitorë të këtyre ditëve fillim pranvere ishin dhe studentët tanë të FA-së. Për të ndarë eksperiencën e tyre me lexuesin e gazetës "Ushtria" të rinjtë tanë sot, por ushtarakët e karrierës nesër, studentet Hanke Pasha dhe Qefli Toleni do të sjellin emocionet e tyre të para.

Si pjesë e studentëve të FA, patët fatin të vizitonit një prej universiteteve ushtarake me histori dhe standard të pa konkurrueshëm, siç është "West Point". Si u gjendët atje?

Për programin e shkëmbimit të studentëve mes dy akademive u përzgjedhëm nga drejtuesit që ne të përfaqësonim AFA-në, pasi fillimisht në muajin mars patëm një vizitë nga dy studentë amerikanë të Akademisë së "West Point".

Si ishte mikpritja ndaj studentëve shqiptarë?

Pritja ishte mjaft e mirë, pasi na bënë të ndiheshim komod atje, duke na mbështetur dhe duke na bërë pjesë të tyre. Pati një angazhim të madh edhe nga pjesa tjetër e studentëve, kjo na la ne përshtypjet më të mira.

Sipas mendimit tuaj cilat janë përfitimet kryesore për një student që studion në "West Point" dhe një student në FASH?

Bazuar në programin arsimor si në të gjitha Akademitë Ushtarake, secila sjell përfitimet e veta, por qëllimi është i



njëjtë dhe ne si akademi po mundohemi që t'i përafrohemi modelit të "West Point". Përfitimi kryesor në të dy rastet është mundësia që na jepet për t'u përgatitur për t'i shërbyer vendit si oficer i Forcave të Armatosura. Një e përbashkët që përfitojnë studentët është paga gjatë studimeve dhe punësimi i siguruar menjëherë pas përfundimit të tyre.

Si është një ditë, për një student në shkollën tuaj dhe si ishte një ditë në "West Point"?

Pamë që programi mësimor ishte më i komplikuar krahasuar me atë që kemi ne, pasi kanë më shumë degë të ndryshme studimi si dhe janë më të angazhuar me aktivitetet fizike. Krahasuar me aktivitetin tonë ditor ata ishin më të ngarkuar, konkretisht në pjesën e parë të ditës, ku studentët ishin të gjithë nëpër klasa sipas degëve të tyre të studimit. Në mbarim të mësimit studentët angazhoheshin me aktivitete fizike, mbledhje apo aktivitete të tjera të

ndryshme kulturore, argëtuese, edukative, të organizuara nga vetë studentët.

Cilat janë gjërat më domethënëse që ju do të donit t'i kishit si pjesën tuaj këtu?

Ajo çfarë na bëri përshtypje më tepër, sa i përket anës ushtarake, ishte hierarkia e komandimit, ku studentët e viteve të ndryshme komandonin njeri-tjetrin por ndryshe nga ne, ata ishin të përzier edhe në nivelet e komandimit me qëllim që çdo student të ketë në vartësi studentë të vitit më të ulët për t'i mësuar më mirë mënyrat e komandimit. Programi ishte një tjetër pikë e fortë e tyre, pasi zbatohet me përpikëri dhe kishte një larmi aktiviteteve që kryheshin gjatë ditës.

Si e shihni të ardhmen në raport me bashkëmoshatarët tuaj që studiojnë atje?

Pas përfundimit të Akademisë, si ata, ashtu edhe ne diplomohemi oficerë



me gradën N/toger dhe fillon karriera ushtarake, por ndryshimi është se ne dalim oficerë të përgjithshëm ndërsa secili student i "West Point" përgatitet gjatë katër viteve në specialitetin e përzgjedhur, kjo edhe për shkak të num-

Një ndër rregullat që pamë ndryshe nga akademia jonë është që studentit në momentin që ngel në një lëndë është i penalizuar për të përsëritur të gjithë semestrin, ndryshe nga këtu që jepet një mundësi e dytë për t'u riestruar vetëm në lëndën mbetëse në përfundim të vitit përkatës. Në këtë rast ne ndihemi pak më të privilegjuar dhe të toleruar në këtë drejtim, por nga ana tjetër mendojmë se kjo mase do t'i shërbente vetë studentit për t'u përkushtuar më shumë në kalimin e sprovave e provimeve me herën e parë.

-Zhvillimi i udhëheqësve të ardhshëm ushtarakë e politikë i ka rrënjët në parimet e një përgatitjeje etike dhe morale si dhe në Kodin e Nderit, sipas të cilit kadetët betohen se, "Nuk do të gënjejnë, nuk do të mashtrojnë, nuk do të vjedhin dhe nuk do të tolerojnë as ata persona që bëjnë gjëra të tilla". Secili kadet sot, është një udhëheqës nesër, thuhet në portalin e Akademisë "West Point", dhe si të tillë janë shembuj për të tjerët.

Çfarë do të thotë kjo për ju sot? Sa i rëndësishëm është ky "postulat" për njerëzit nën uniformën ushtarake, pjesë e së cilës do të jeni ju nesër?

Ky është parimi i çdo studenti ushtarak që nga dita që bëhet pjesë e Akademisë dhe derisa kalitet për t'u bërë oficer. Rëndësi ka jo vetëm të



rit të madh të specialiteteve në ushtrinë amerikane. Ne e marrim specialitetin me përfundimin e studimeve dhe më pas kryejmë kualifikimin e nevojshëm për këtë specialitet.

Cilat janë të përbashkëtat dhe të veçantat e dy universiteteve?

E përbashkëta mes dy akademive është qëllimi i njëjtë, dhe ndryshimi është që programi studimor në "West Point" është katërvjeçar ndërsa këtu është trevjeçar, numri i studentëve është shumë më i madh, krahasuar me ne, pasi këtu vjet është rihapur akademia, si dhe logjistika atje është më e pasur krahasuar me atë këtu.

Cilat janë disa prej rregullave më të forta që gjetët në "West Point", duke ditur që ai universitet ka rregulla hermetike? Si u ndjetë përballë tyre?

mos gënjejnë, mashtrojnë apo vjedhin vetë, por të mos tolerojmë as kolegët e të tjerët nëse i bëjnë këto. Kjo ndikon direkt në formimin e integritetit moral të secilit student dhe për më tepër edhe në formimin e karakterit të tij, që do ta shoqërojë gjatë gjithë jetës së tij në uniformë dhe jashtë saj.

Sollët për shokët tuaj një eksperiencë unike, e cila ju hapi një dritare të re, për atë se çfarë kërkoni dhe se çfarë po ju ofrohet. Së shpejti, me këmbënguljen e ministrit Peleshi dhe angazhimin maksimal të FA-së, ju do të keni ambiente universitare dhe akademike të njëjta me atë të sjellë nga përtej oqeanit. Për këtë kërkohet dhe angazhimi juaj për të arritur nivelin e miqve tuaj të "West Point".

Suksese studentëve tanë në rrugëtimin e tyre të vështirë dhe dinjitoz!



Jo film me metrazh të shkurtër, por histori e vërtetë, nga ato drithërueset, që luftërat sollën siç do të keqe tjetër. Viti 1920, më shumë se një shekull, duket se koha ka mbetur aty, si një orë e prishur, akrepat e së cilës nuk mund të lëvizin lodhur kohërash mjerane, në atë fillim të egër të luftës së parë botërore, ku ende pa u mbyllur plagët e saj, orekset e mëdha filluan luftën e dytë.



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

“Në luftë nuk ka nesër”

Jo film me metrazh të shkurtër, por histori e vërtetë, nga ato drithërueset, që luftërat sollën siç do të keqe tjetër. Viti 1920, më shumë se një shekull, duket se koha ka mbetur aty, si një orë e prishur, akrepat e së cilës nuk mund të lëvizin lodhur kohërash mjerane, në atë fillim të egër të luftës së parë botërore, ku ende pa u mbyllur plagët e saj, orekset e mëdha filluan luftën e dytë, ku bota u përpi nga vargonj tmerri, ku puthjet u ngurtësuan lotësh, ku jeta mori ngjyrën e gjakut. Dhe prapë jetohej, dashurohej dhe rilindte çdo ditë një jetë e re.

**Sot?! E ardhmja e tyre
a tashmja jonë**

Ukraina çdo ditë të së tashmes na kujton sa pranë të kaluarës paskemi qenë. Akrepat e orës çuditërisht tregojnë të njëjtën gjë. Gjyshja nga ana tjetër më thotë: “...sa ngjajmë ne të dyja moj vajzë!”

**“Lufta në vend vazhdon,
por jeta nuk ndalet”**

Që nga fillimi i luftës ruso-ukrainase, gati tri javë më parë, 10 683 çifte në të gjithë Ukrainën janë martuar.

Të paktën 10767 foshnja



1920-1963 Ndarjet janë gjithmonë të trishta!”,
“Puthjet e lamtumirës”

kanë lindur në vend.

“Në luftë nuk ka nesër”

Dashuria, që në mugëtirën e kohëve, pasi ajo duhet të ketë qenë një nga ndjesitë e para, ku pas shekujve

të instinktit, të lidhjes dhe bashkimit, dashuria mori formë, u mbrujt, me afsh dhe dëshirë, me ëndrra dhe ngjizma të ngrohta mishi e gjaku, u zbukurua, hodhi shtat mbi lëndina, vreshta e ullishta, për të shkuar drejt ekzistencës dhe përkushtimit. Rrahje zemre, dihatje, pritje, ankth dhe net të pagjuma... dhe përsëri një ag në pritje.

Kjo ishte ndjesia, kjo duhet të jetë mendoj ndjesia e çdo udhëtari që udhëton në ato kodrina e bregore ku është ngjizur kjo këngë e vjetër si bota, këngë e përhershme e kënduar në festa pagane e fetare, pasi dashuria ka vazhduar gjithnjë dhe në kohë eklipsesh e furtunash, luftërash, holokaustesh, gjëmash e vdekjesh të mëdha. Dashuria ka rrjedhur si ujët e burimeve në ujët e paqës të Jordanit, si lumenjtë që shkojnë drejt brigjeve të Detit të Vdekur apo Mesdheut.

Dashuri dhe luftë ... Do të duket se ajo që mund të jetë më e kundërta me këto dy koncepte, sikur të mohosh njëri-tjetrin. Sidoqoftë, në realitet, duke parë nga afër faktet dhe episodet e Luftës... Prej kohësh është vënë re

tologjike e luftës për shoqërinë dhe individin lindi një dëshirë reciproke dhe diametralisht të kundërt midis luftëtarëve, të paktën për ca kohë për t'u izoluar nga realitetet e tmerrshme të luftës dhe vdekjes, për të rikrijuar, edhe pse për një çast të shkurtër, një cep të jetës paqësore, kundërshtoni jetën deri në vdekje në vetëdijen tuaj dhe jetën e përditshme, dhe me sjelljen tuaj të pohoni paracaktimin e fitores së të parit mbi të dytën.

Dashuria midis një burri dhe një gruaje është pikërisht manifestimi më i ndritshëm i jetës, si dhe dëshira për riprodhim, e lidhur pazgjidhshmërisht me të. Kjo është arsyeja pse, përkundër tmerreve të luftës dhe kërcënimit me vdekje, të cilat gjetën konfirmim të përditshëm në vdekjen masive të njerëzve, ose më mirë, përkundër gjithë kësaj, dashuria në ushtri në terren ishte një pjesë e natyrshme dhe integrale e jeta e përditshme e frontit gjatë Luftës së Madhe Patriotike, nga e para në ditën e saj të fundit... Dashuria si kujtim dhe pritje, si ëndërr apo dëshirë, si letra e fundit para një beteje vdekjeprurëse, nga e cila ata nuk prisnin të dilnin të gjallë, si një dëshmi për një mik për të vizituar nusen pas luftës, si një kalimtare por një shpërthim



Çifti i mjekëve ukrainas kurorëzon dashurinë e tyre



shumë herë se lufta mpreh ndjenjat, ndjenjat dhe emocionet njerëzore në një shkallë të jashtëzakonshme. Për më tepër, natyra ekstreme dhe katastrofike, ose më saktë, pa-

jashtëzakonisht i fortë pasioni në një njohje të shkurtër, si një romancë në fushën ushtarake, e cila pati vazhdimësi të ndryshme pas luftës...

Finlanda dhe Suedia drejt anëtarësimit në NATO

Aleanca praktikon ndërveprimin ajror me Finlandën dhe Suedinë

Aleatët dhe partnerët e NATO-s, Finlanda dhe Suedia patën një javë bashkëpunimi intensiv mbi qiellin e Estonisë, në stërvitjen “Ramstein Alloy”, stërvitje që ka përfunduar. Stërvitja e rregullt e NATO-s u fokusua në skenarët e botës reale me të cilat përballen personeli i Policisë Ajrore të NATO-s, i vendosur në rajonin e Baltikut. Stërvitjet përfshinin trajnim luftarak ajror, furnizim me karburant në ajër dhe identifikimin dhe shoqërimin e një avioni që kishte humbur komunikimin. Stërvitja ishte një mundësi për t’u trajnuar së bashku dhe për të përmirësuar aftësinë e forcave ajrore të NATO-s së bashku, si dhe me partnerët. Morën pjesë ekuipazhet dhe avionët nga Belgjika, Republika Çeke, Estonia, Franca, Gjermania, Spanja, Turqia dhe MB si dhe bashkë me to edhe forcat ajrore finlandeze dhe suedeze.

Skenarët e Policimit: Forcat Ajrore aleate dhe partnere kryen përsëritjen e parë të trajnimit të përbashkët për policimin ajror mbi Detin Baltik për të rritur kohezionin dhe ndërveprueshmërinë e Aleancës. Ushtrimi “Ramstein Alloy” mbuloi dy ditë trajnimi për praktikimin e skenarëve realë me të cilat përballen personeli i Policisë Ajrore të vendosur në rajonin e Baltikut. Ky trajnim është jetik për policimin ajror të Baltikut dhe detashmentet e përmirësuar të policisë ajrore. “Avionët luftarakë aleatë stërviten vazhdimisht gjatë gjithë vitit me aleatët dhe partnerët për të ruajtur nivelet më të larta të gatishmërisë dhe performancës”, -tha gjenerallejtnant Pascal Delerce, zëvendës komandanti i Komandës Ajrore Aleate. “Stërvitje të tilla si “Ramstein Alloy” janë themeli i misionit tonë të Policisë Ajrore, i cili është pjesë e parandalimit 360 gradë të Zonës Euro-Atlantike”, -shtoi ai.

Skenarët kryesorë që kryejnë pjesëmarrësit janë përgjimi me lëvizje të ngadaltë dhe humbja e komunikimit civil me shoqërim. Zonat e tjera stërvitore përfshijnë një nxjerrje të simuluar të ekuipazhit me aktivizimin e zinxhirit të Kërkimit dhe Shpëtimit, stërvitjen luftarake në ajër dhe furnizimin me karburant në ajër.

Rusia paralajmëron NATO-n kundrejt anëtarësimit të Suedisë dhe Finlandës

Ndërkohë në Stokholm, kryeministret e Suedisë dhe Finlandës, të dy vendeve me kulturë neutrale dhe jo aleancë ushtarake, dhanë një deklaratë të përbashkët, se falë pushtimit rus të Ukrainës, ata po shqyrtojnë aplikimin për anëtarësimin në NATO. “Është rreth 24 shkurtit”, -u tha gazetarëve para pak ditësh kryeministrja e Suedisë Magdalena Anderson, e cila përmendi datën e pushtimit të fundit ushtarak të Ukrainës nga Rusia. “Mjedisi i sigurisë ka ndryshuar plotësisht”, -tha ajo.

Edhe kryeministrja e Finlandës Sanna Marin tha nga ana e saj se: “Ne duhet të jemi të përgatitur për të gjitha llojet e veprimeve nga Rusia”, duke shtuar se Finlanda do të vendosë të aplikojë në NATO brenda disa javësh. Të dy vendet kanë bllokuar tashmë trafikun ajror të Rusisë, por njoftimi i anëtarësimit në NATO shtoi më tej “zemërimin” e Kremlinit, i cili vetëm një ditë më pas, kërcënoi të dy vendet nëse bashkohen me aleancën ushtarake tashmë prej 30 anëtarësh.

Rusia paralajmëroi NATO-n se nëse Suedia dhe Finlanda i bashkohen aleancës ushtarake, “atëherë Rusia



do të duhet të forcojë mbrojtjen e saj dhe se nuk mund të flitet më për një Baltik të lirë nga armët bërthamore”, -tha ajo. “Nuk mund të flitet më për ndonjë status pa armë bërthamore për Baltikun, ekuilibri duhet të rivendoset,” -tha Dmitry Medvedev, nënkryetar i Këshillit të Sigurimit të Rusisë. “Deri më sot, Rusia nuk ka marrë masa të tilla dhe nuk do të merrte”, -tha ai. Edhe zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, tha gjithashtu më herët se anëtarësimi i Finlandës dhe Suedisë në NATO nuk do të sillte stabilitet në Europë. “NATO është një instrument i drejtuar për konfrontim”, -tha ai. Zëdhënësjë e Ministrisë së Jashtme ruse, Maria Zakharova, ka kërcënuar gjithashtu në fund të shkurtit me pasoja të rënda ushtarake dhe politike.

Por Kryeministrja e Finlandës, Sanna Marin, theksoi se Helsinki është afër marrjes së vendimit që brenda javësh të aplikojë për anëtarësim në NATO,

ndërkohë që sulmi i Rusisë ndaj Ukrainës po vazhdon. “Unë mendoj se do të ndodhë shumë shpejt. Brenda javësh, jo brenda muajve”, -tha kryeministrja Sanna Marin para gazetarëve në Stokholm. Kurse homologia suedeze e kryeministres Marin, Magdalena Andersson, paralajmëroi gjithashtu për një ndryshim të madh të politikës për shtetin e saj, (si rezultat i pushtimit rus të Ukrainës), duke thënë në të njëjtën konferencë për shtyp se, për shkak të situatës së sigurisë, Stokholmi po kërkon gjithashtu t’i bashkohet NATO-s. Anëtarësimi në NATO i njërit prej këtyre shteteve, ose i të dy shteteve, do të ishte një ndryshim i madh për sigurinë e Europës. Prej kohësh, anëtarësimi në NATO i Finlandës dhe Suedisë përjashtojë, ndryshe nga tani që ai po duket më i mundur, theksojnë ekspertët. Në takimet e kryeministreve, e në një raport aktual të Këshillit të Sigurisë bëhet fjalë për gjendjen e re.

Nga Lufta e Ftohtë deri në aneksimin e Krimesë në vitin 2014, dukej se asgjë nuk mund të nxiste Finlandën dhe Suedinë që t’i bashkoheshin aleancës ushtarake të NATO-s, duke hequr dorë nga pavarësia e tyre ushtarake. Vitet e fundit, marrëdhëniet mes dy vendeve dhe NATO-s janë forcuar, edhe pa qenë shtete anëtare. Në fund të marsit, Suedia dhe Finlanda morën pjesë në një stërvitje të madhe të NATO-s në Norvegji. Veçanërisht në Finlandë, ka një ndërgjegjësim në rritje se ky vend është shumë i cenueshëm për shkak të kufirit të tij prej rreth 1300 km me Rusinë. Lufta në Ukrainë tregon edhe më qartë se pa anëtarësimin në NATO, nuk mund të presësh mbështetje të plotë ushtarake nga vendet e tjera perëndimore në rast emergjence.

Në fillim të janarit, sondazhet treguan se 30 për qind e finlandezëve ishin në favor të anëtarësimit në NATO. Në fund të marsit, kjo shifër ishte mbi 60

për qind. Dëshira për mbrojtje nga fqinji rus është rritur që nga fillimi i luftës në Ukrainë. Kurse në Suedi, shumë njerëz tradicionalisht janë krenarë për pavarësinë e tyre ushtarake. Për më shumë se 200 vjet, vendi nuk ka qenë i përfshirë drejtpërdrejt në asnjë luftë. Ky neutralitet lejoi që Suedia të shpëtonte nga luftërat botërore të shekullit të 20-të, por pas fillimit të luftës në Ukrainë, një sondazh tregoi se pothuajse gjysma e suedezeve ishin në favor të anëtarësimit të vendit në NATO.

Anëtarësimi i Finlandës dhe Suedisë në aleancën ushtarake perëndimore jo vetëm që zgjeron territorin e NATO-s me 300 000 milje katrore në verilindje, por kufiri i NATO-s me Rusinë do të zgjerohet në rreth 1600 milje. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg, i cili i quajti Suedinë dhe Finlandën “partnerët tanë më të afërt”, tha në fillim të prillit se të gjitha vendet e NATO-s prisnin që “aleatët t’i mirëpresin ata”. “Ne e dimë se nëse vendosin të aplikojnë, ata lehtë mund t’i bashkohen kësaj aleance,” -shtoi ai.

Finlanda dhe Suedia pritet të aplikojnë në javët e ardhshme, por pranimi në NATO varet gjithashtu nga marrëveshja unanime nga të 30 anëtarët aktualë të Aleancës. Ky proces mund të zgjasë disa muaj. Ndërkohë, Finlanda dhe Suedia po forcojnë trupat e tyre dhe po rrisin shpenzimet vjetore për mbrojtjen civile dhe armët. Në shkurt, qeveria finlandeze porositi “Lockheed Martin” për 64 F-35, me çmim mbi 9 miliardë dollarë. Suedia, e cila kishte një buxhet të mbrojtjes prej rreth 7 miliardë dollarë në vitin 2021, pritet ta rrisë atë shumë në rreth 11 miliardë dollarë, që është rreth 2 për qind e PBB-së që kërkohet nga vendet anëtare të NATO-s.

“Deep Dive”

Këshilltarja gjinore e Shtabit Usharak Ndërkombëtar (IMS), nënkolonel Katherine Prudhoe dhe stafi pritën Sesionin e tyre të dytë “Deep Dive”, duke u fokusuar në lidhjen e trefishtë të ndryshimeve klimatike, perspektivës gjinore dhe sigurisë. Ky session theksoi rreziqet ekologjike për sigurinë dhe planifikimin ushtarak, si dhe rëndësinë e integritetit të perspektivës gjinore.

Ekspertiza e çështjes u ofrua nga znj. Gergana Vaklinova, shefja e Seksionit të Zhvillimit të Koncepteve dhe Eksperimentimit për Qendrën e Ekselencës së NATO-s për Menaxhimin e Krizave dhe Reagimin ndaj Fatkeqësive (CMDR CoE), nënkoloneli Matthias Duschcherer, këshilltari gjinor për Korpusin Gjerman-Holandez, dhe kolonel Thammy Evans, një anëtar i lartë në Qendrën “GeoTech” të Këshillit Atlantik. Pjesëmarrësit e aktivitetit ishin kolegë nga Shtabi Ndërkombëtar dhe Shtabi Ush-

Kuptimi i ndikimeve të ndryshimeve klimatike, perspektiva gjinore dhe siguria



arak Ndërkombëtar, Shtabi Suprem i Fuqive Aleate në Europë (SHAPE), Komanda Aleate e Transformimit (ACT), si dhe anëtarë nga Qendra të ndryshme të Ekselencës.

Secili folës ndau pikëpamjet e tij për sfidat e ndryshme, mundësitë dhe mënyrat për të ecur përpara në këtë lidhje të rëndësishme. U vu në dukje se një analizë gjinore (mbi ndryshimin e

klimes) mund të provojë si një ndryshim themelor i lojës për zbutjen e ndikimit të mundshëm në shkaqet rrënjësore dhe nxitësit e konflikteve në të ardhmen”. Diskutimi i frytshëm çoi në shkëmbime mbi përshkallëzimin e konfliktit për shkak të dobësive të shtuara klimatike, njohjen e ndikimeve të ndryshimeve klimatike si në Veri ashtu edhe në Jug përmes perspektivës

gjinore dhe të kuptuarit se trajnimet gjinore mund të konsiderohen hapi i parë, por duhet të zhvillohet njohja e mëtejshme e treguesve gjinorë dhe implikimi i tyre për konfliktin ose mjedisin. “Është thelbësore të kemi një kuptim të fortë të perspektivës gjinore në hartimin e politikave që do të prekin, jo vetëm aleatët e NATO-s, por botën në përgjithësi. Ndërsa bota po përballlet me kërcënime të përshpejtuara të ndryshimeve klimatike dhe konfliktit, folësit u kërkuan pjesëmarrësve të mbanin mend se këto çështje i prekin të gjithë, por jo njëllonj”, -përfundoi nënkoloneli Prudhoe.

Gjatë viteve të fundit, NATO ka ndërmarrë shumë hapa për të adresuar shqetësimet e sigurisë të ndryshimeve klimatike dhe vazhdon të përparojë në këtë temë e Vlerësimin e saj të ardhshëm të Ndikimit të Ndryshimeve Klimatike, si dhe me Raportin e parë të Progresit të Ndryshimeve Klimatike dhe Sigurisë.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s merr pjesë në takimin e liderëve të organizuar nga Presidenti Biden

NATO i ofron Ukrainës ndihmë të mëtejshme ushtarake, ekonomike dhe humanitare

MSC. MIMOZA GOLIKJA

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg mori pjesë në një konferencë të sigurt të organizuar nga Presidenti i SHBA-së Joe Biden, më 19 prill 2022, me qëllim për të adresuar ofensivën e fundit të Rusisë në rajonin e Donbasit të Ukrainës, kostot e rënda, që i vihen Kremlinit dhe koordinimin për mbështetjen e mëtejshme për Ukrainën.

Telefonata përfshinte kryeministrin britanik Boris Johnson, kryeministrin kanadez Justin Trudeau, presidentin francez Emmanuel Macron, kancelarin gjerman Olaf Scholz, kryeministrin italian Mario Draghi, presidentin polak Andrzej Duda, presidentin rumun Klaus Iohannis, si dhe presidentin e Komisionit European Ursula von der Leyen, presidentin e Këshillit European Charles Michel dhe kryeministrin japonez Fumio Kishida.

Udhëheqësit dënuan sulmin aktual të Rusisë përgjatë vijës së frontit në Ukrainën lindore, përfshirë granatimet e rënda që po shkaktojnë vuajtje edhe më të mëdha njerëzore. Udhëheqësit theksuan se Presidenti Putin duhet t'i japë fund luftës menjëherë dhe ata ranë dakord për rëndësinë e imponimit të kostove edhe më të larta ndaj Moskës derisa ajo ta bëjë këtë. Sekretari i Përgjithshëm përditësoi kolegët e tij mbi punën për të përforcuar parandalimin dhe mbrojtjen e NATO-s, duke theksuar se NATO do të bëjë gjithçka që është e nevojshme për të siguruar dhe mbrojtur të gjithë aleatët. Ai gjithashtu informoi krerët e tjerë mbi punën e aleatëve për t'i ofruar Ukrainës ndihmë të mëtejshme ushtarake, ekonomike dhe humanitare.

Përgjigja e NATO-s ndaj pushtimit rus të Ukrainës, reagimi ndaj konfliktit Rusi-Ukrainë

Ndërkohë që NATO i ofron Ukrainës ndihmë të mëtejshme ushtarake, ekonomike dhe humanitare, Aleanca ka dënuar në termat më të ashpër të mundshëm pushtimin e plotë të Rusisë në Ukrainë, e cila është një vend i pavarur, paqësor dhe demokratik dhe një partner i ngushtë i NATO-s. “Aleanca i bën thirrje Presidentit Putin që të ndalojë menjëherë këtë luftë, të tërheqë të gjitha forcat e tij nga Ukraina pa kushte dhe të angazhohet në diplomaci të mirëfilltë. Një Ukrainë sovranë, e pavarur dhe e qëndrueshme, e përkushtuar fort ndaj demokracisë dhe shtetit të së drejtës, është çelësi për sigurinë euroatlantike”, -thotë NATO në qëndrimin e saj.

Marrëdhëniet midis NATO-s dhe Ukrainës datojnë që në fillim të viteve 1990 dhe që atëherë janë zhvilluar në një nga partneritetet më thelbësore të NATO-s. Që nga viti 2014, në vazhdim të konfliktit Rusi-Ukrainë, bashkëpunimi është intensifikuar në fusha kritike. NATO ka miratuar një qëndrim të vendosur në mbështetje të plotë të sovranitetit dhe integritetit territorial të Ukrainës brenda kufijve të saj të njohur ndërkombëtarisht. Aleatët dënojnë dhe nuk do ta njohin aneksimin ilegal dhe të paligjshëm të Krimesë nga Rusia dhe denoncojnë pushtimin e saj të përkohshëm. Aleanca dënon gjithashtu vendimin e Rusisë në shkurt 2022 për të zgjeruar njohjen e të vetëshpallurit “Republika Popullore e Donetskut” dhe “Republikës Popullore të Luhanskut”



në Ukrainën lindore, e cila është një shkelje flagrante e ligjit ndërkombëtar që minon më tej sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës. Për më tepër, NATO dënon në termat më të ashpër të mundshëm pushtimin në shkallë të plotë të Rusisë në Ukrainë duke filluar në shkurt 2022, i cili është krejtësisht i pajustificuar dhe i paprovokuar. Kjo është një shkelje e rëndë e ligjit ndërkombëtar dhe një kërcënim serioz për sigurinë euroatlantike. Aleatët e NATO-s vendosën në vitin 2014 të pezullojnë të gjithë bashkëpunimin praktik civil dhe ushtarak me Rusinë, duke lënë të hapura kanalet politike dhe ushtarake të komunikimit. Në shkurt të vitit 2022, aleatët miratuan një paketë të paprecedentë masash kufizuese, përfshirë sanksione masive dhe të rënda ekonomike, të cilat i janë vendosur Rusisë si rezultat i pushtimit të saj në shkallë të plotë të Ukrainës. Aleatët e NATO-s i bëjnë thirrje Rusisë që të ndërpresë menjëherë veprimet e saj ushtarake dhe të tërheqë të gjitha forcat e saj nga brenda dhe rreth Ukrainës, të respektojë plotësisht ligjin ndërkombëtar humanitar dhe të lejojë akses dhe ndihmë të sigurt dhe të papenguar humanitare për të gjithë personat në nevojë. Ata gjithashtu i bëjnë thirrje Rusisë që të ndalojë kufizimin e lundrimit në pjesë të Detit të Zi dhe pengimin e hyrjes në Detin Azov. Ndërkohë gjatë gjithë krizës, janë zhvilluar konsultime të rregullta në Komisionin NATO-Ukrainë (NUC) në funksion të kërcënimeve të drejtpërdrejta me të cilat përballet Ukraina ndaj integritetit të saj territorial, pavarësisë politike dhe sigurisë. NUC u mblodh për takime të jashtëzakonshme në funksion të përdorimit të pajustificuar të forcës ushtarake nga Rusia kundër anijeve ukrainase pranë ngushticës së Kerçit, në nëntor 2018 dhe ngritjes kërcënuese ushtarake të Rusisë në prill 2021. Takime të tjera të jashtëzakonshme të NUC u zhvilluan në selinë e NATO-s në janar dhe shkurt 2022, të fokusuar në ngritjen e vazhdueshme ushtarake të Rusisë dhe sulmin e paprovokuar ndaj Ukrainës.

NATO është një aleancë mbrojtëse e 30 vendeve anëtare të saj

Motër e vëlla kanë lindur në lagjen “Goricë” në një familje intelektualësh.

Ka qenë korriku i vitit 1943 kur nga personat që i ndiqnin u spiunua për aktivitetin që kryente Margarita dhe Kristaqi. Ata sapo kishin mbaruar një takim me të rinjtë e qytetit në lagjen “Mangalem” kur janë arrestuar. Në momentin që Margarita ka mbaruar takimin është ndarë me pjesëmarrësit dhe së bashku me të vëllain janë nisur për në shtëpi, ku kishin familjen. Pasi kanë kaluar Urën e Goricës dhe janë futur në rrugicat e kalldrëmta të lagjes në errësirë përballën me një toga ushtarësh fashistë italianë. Edhe pse vëlla e motër kanë bërë rezistencë, çdo gjë ka qenë e kotë se numri i fashistëve ishte shumë i madh dhe si të tillë ata arritën t’i arrestonin në afërsi të banesës së tyre. Nga zhurma e krijuar banorët e lagjes të tronditur nga fashistët e kuptuan se toga fashiste kishte arrestuar dy nga veprimtarët e lëvizjes, Margaritën dhe Kristaq Tutulani. Ata me duart të lidhura janë shoqëruar për në birucat famëkeqe të fashistëve në Berat. Aty janë torturuar barbarisht nga xhelati fashist, por ata nuk treguan asgjë, se me cilin kishin lidhje dhe emrat e shokëve të tyre. Pas torturave fashistët kuptuan se prej gojës së tyre nuk do të dilte asnjë informacion. Pasi kaluan një natë në birucat e fashizmit, natën e dytë komanda fashiste për t’i shpëtuar ndonjë ndërhyrje të njësiteve guerilje vendosi që t’i transferonte nga Berati në një vend tjetër për t’i pushkatuar. Një kamion i mbushur me fashistë qëndronte para burgut. Aty u hipën motër e vëlla. Makina ka kaluar me shpejtësi në maksimum, duke marrë drejtimin për në Lushnje. Pasi la pas Rrogozhinën makina ndalohet nga një veturë që e shoqëronte gjatë gjithë rrugës. Në vendin e ndalimit nga makina zbresin karabinierët dhe duke zbatuar urdhrin e epororit zbresin nga makina Margaritën dhe Kristaq Tutulani. Aty pranë ndodhej një hendeq, pasi vendi ishte i shkrët me ferra dhe gjembaçë. Kapiteni i afrohet Kristaqit duke i thënë: “Po ju japim mundësinë e fundit për t’ju lënë të lirë, por me një kusht, të tregoni, se cilët janë shokët tuaj?”. Por kur panë se Kristaqi nuk po nxirrte asgjë nga goja, iu drejtuan Margaritës me shpresën se mos e thyenin atë si vajzë. Kapiteni i drejtohet: “Fol zonjushë, nëse nuk doni që tua bëjmë trupin shoshë”. Por ajo iu kthehet: “Ju e morët përgjigjen nga vëllai im”. Në këtë kohë kapiteni i jep skuadrës shenjë të hapë zjarr mbi Kristaqin. Më çastin e breshërive të plumbave Margarita me duart të lidhura duke i mbledhur të gjitha forcat e veta godet mareshalin në kokë dhe e rrëzon përdhe. Më pas hidhet mbi trupin e të vëllait, i cili ishte mbuluar nga gjaku. E pas kësaj mbi Margaritën shkrehet e gjithë karikatori i armës. Ajo edhe pse kishte marrë disa plumba ngrihet në këmbë dhe thërret “Rroftë Shqipëria”, por nuk arriti ta çojë fjalën deri në fund. Ata u vranë në Gosë të Kavajës. Asgjë nuk mbeti pa u mësuar atë natë në Gosë të Kavajës. Shokët u betuan për hakmarrje. Motër e vëlla ranë dëshmor, më 6 korrik të vitit 1943, në Gosë të Kavajës.

Ja si i kujton Afërdita Tutulani, motër e vëlla, Margaritën e Kristaqin: “...Gjyshi im ishte me arsim të lartë, një nga firmëtarët me Ismail Qemalin të Deklaratës së Pavarësisë. Ne na thoshte betohuni, ne betoheshim për Zotin dhe ai thoshte: Jo, betohuni për nder e për flamur! Ky ishte betimi që bënim ne. Ai, atë frymë na transmetoi ne, familjes, babait tim që ka qenë deputet, ministër i Drejtësisë dhe Financave dhe që e helmoi Zogu. Kështu që këtë frymë ne e morëm në familje. Shkon brez pas brezi edukimi. Të edukuar më këtë frymë, Kristaqi ishte në Liceun e Korçës e Margarita në shkollën “Nëna Mbrerëshë”. Isha në shkollën e saj këtë periudhë dhe më thoshin se mbanin mend se ka qenë shumë e bukur. Më erdhi inat se, mirë ka qenë e bukur, por ka qenë edhe luftëtare. Ishin ëndrra, e donin jetën, natyrën, e adhuronin Beratin. Kanë qenë njerëz me një botë shpirtërore të jashtëzakonshme, ishin artistë nga shpirti. Eh, takimi i fundit me Margaritën dhe Kristaqin!...Ata i arrestuan dhe i çuan në burg, ndërkohë kapën mamanë me gjithë time motër për t’iu bërë presion. Ato ishin nisur të shkonin në kampet t’i kërkonin, në fakt ato ishin në burgun e Beratit. Unë shkoja dhe iu çoja ushqimin. I kishin torturuar, tim vëlla e gjeta me thonj të hequr, të gjakosur. Fillova të qaja, natyrisht. Të keni kujdes dokumentet, më thanë, se kishim shumë dokumente në shtëpi dhe i thuaji mamasë, më tha, se të tërë fëmijët partizanë janë fëmijët e saj. Duke zbritur, takova Margaritën, se ajo ishte të burgu i grave. Donte një limë që të priste hekurat, po nuk ia arriti; edhe ajo 100 porosi më dha... Kur vajta herë tjetër, më keq ishin tortu-

ruar, ndërsa ditën e tretë burgu ishte i rrethuar. “Do të na çojnë në kampet e përqendrimit, unë do të bëj si Qemal Stafa”, -më tha Kristaqi. “Do të flas në gjyq.” Kjo ishte ëndrra e tij. Të mund të mbronte bindjet dhe mendimet e tij. Ky ishte takimi i fundit. Kur u ktheva sërish, ishte shumë vonë. ...Më merr malli shumë për ata. Kam bërë shumë mirë që bëra një libër për ta, sepse kështu flas me ta, edhe politikë bëj me ta...Margarita është torturuar, por ka rezistuar. Vetëm në momentin kur kanë qëlluar Kristaqin, është vërsulur dhe i ka përshkruar i njëjti plumb...”

Çfarë shkruan për heroinën Margarita Tutulani në poezinë “Margaritë moj” , poeti i njohur Fatos Arapi: “... Shojka ime, moj./ me dy sy si nata të mëdhenj, të zez./ me bukurinë tonë të virgjër./ vdekjen po ushqejmë./ se kjo tokë ka ftohtë./ mar-dhi./ e ka ngrire./ Dhe ne biem mbi të, porsi bllaca zjarri./ Futemi nën dhë porsi rrënjë ëndrrash./ Që të vijë pranvera, që të vijë behari./ Toka përmbi ne e balta të shkrijë./ Ëndrrat të shpërthejnë, si shpërthen bari./ Dashuria jonë./ Me dy sy si nata çuditërisht të zez./ Nga plumbat armike prerë mes për mes/ Dashuri e lindur/ Dashuri e rritur./ Nën qiejt e thyer të varfërisë shqiptare./ Dashuri tragjike./ Për botën e madhe./ Margaritë, moj./ Motra ime, moj./ Shojka ime, moj” Për aktin e lartë atdhetar, emri i heroinës Tutulani, është vendosur pas çlirimit në disa institucione e objekte të Beratit e vende të tjera, janë ngritur përmendore dhe memoriale.

“Heroina e Popullit” Persefoni Kokëdhima, trimëresha shqiptare nga Qeparoit

“Heroina e Popullit” Persefoni Kokëdhima, u lind në Qeparo të Himarës në vitin 1924. Ishte veprimtare e Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare dhe veproi me të rinjtë e fshatit duke u ardhur në ndihmë partizanëve. Ajo u rreshtua në radhët e Brigadës VI-Sulmuese. U shqua në luftimet që u zhvilluan në Shën Vasi të Sarandës. Ajo ishte vajzë e Qeparoit e “Fshatit të kapedanëve”, e këtij fshati me

histori gjithë lavdi. Ishte nga një familje e fisme e mirënjohur, me prejardhje nga mëhalla “Bragjini” e Tërbaçit. Ishte Çupë labe, me tipare të larta morale, trimërore, atdhetare. Persefoni e kishte filluar luftën çlirimtare e revolucionare para se të dilte partizane. Aktivizohej në grupet e rinisë komuniste dhe ka kryer një sërë aksionesh e detyrash duke qenë në ko-

mandë të një grupi shokësh e shoqesh të besuara. Në fillim të vitit 1944, u hodh në radhët partizane. U shqua në luftimet që u zhvilluan në Shën Vasi të Sarandës, ku në Malin e Bardhë u bë një qëndresë e fortë kundër nazistëve gjermanë, të cilët sulmonin për të hapur rrugën në drejtim të Bregdetit dhe maleve të Kurveleshit. Ishin luftime të ashptra, që zgjatën 15 ditë e net. Më 16 qershor, kompania e saj zuri pozicione tek Qafa e Manastirit. Shtrirë nëpër gurë, nën diellin përvëlues, ajo vështronte bukuritë e Jonit kaltrëros. Partizanët kishin etje të madhe për ujë dhe qëndronin të pamposhtur e të pa lëvizur që të mos diktoeshin nga gjermanët, të cilët ishin shumë dhe afroheshin nga Nivica drejt Bubanit. Situata po rëndohej. Persefoni rrëshqiti barkas tatëpjetë mbi gurët e mprehtë që të prisnin si thikë, ndërsa nazistët po afroheshin gjithnjë e më tepër. Në ato kushte të vështira shkoi e mbushi katër pagure me ujë dhe u kthye, me të cilin partizanët njomën buzët e tyre të thara... Lufta filloi. Motoçiklisti gjerman që ecte në krye të kolonës, u përmbys nga një krismë e vetme pushke. Patrulla treshe pas tij ra barkas e po kërkonte me sy për të zbuluar kundërshtarin që shtiu dhe u vrau shokun. Pas tyre udhëtonte kolona gjermane me 30 makina. U hap zjarri partizan. Nisi artilleria e armikut. Në vend dukej vetëm tym e flakë. Gjermanët grupe-grupe të vogla gjysmë të përklur, ngjiteshin përpjetë drejt partizanëve dhe gjuanin me automatik. Mitralozi i partizanëve viltte zjarr dhe “paloste” nazistët njeri pas tjetrit. Dikush thërriste: “Të lumtë, o Bajazit Shehu!”. Por ky trim ishte vrarë dhe me mitralozin e tij hapte zjarr Persefoni! Kjo u mësua në mbrëmje, pas thyerjes së sulmit të tretë të gjermanëve...Por një predhë e armikut ra aty afër dhe e goditi Persefoninë. Plaga e saj rridhte gjak. Me urdhër të komandës, ajo u detyrua të strehohej në një familje, e cila ishte e lidhur me luftën dhe pas dy ditësh u nis për në Qeparo, që nuk ishte më larg se dy orë. Në fshat ishte dhënë alarmi se “po shkonin gjermanët”. Nëna e saj, Kaliopi ishte në hall se “ku ta fshihte vajzën partizane”. Persua u ngrit, u vesh ngadalë, mori automatikun dhe u nis lart malit Gjivilash. Pas saj u nis e motra, e cila e arriti në vendin e quajtur “Ziliko” tek burimi i ujit. Atje, ajo pa Person të shtrirë në klapi. E trembur për gjendjen e saj, motra thirrri Lekanën, një plakë të urtë që jetonte aty më sipër me të shoqin. E morën pleqtë e mirë Persefoninë në krah dhe e futën në kasolle. Ajo s’përmendej por motra i rrinte tek koka dhe qante. Plaka i shërbeu me banja të ftohta në kokë e në duar deri sa i ranë pak ethet. Kur ajo u përmend, plaka gëzoi...por në derë hynë gjashtë burra, tre gjermanë dhe tre ballistë me armë në duar. “Hë moj trimëreshë, do të na sjellësh lirinë? Ngrehu, se turpëruat bregdetin maleve me djem! Hë, ç’ pret akoma, mos do trompohi?”. “Lidheni” -u dëgjua një zë. Fshati ishte mbledhur sipas urdhrit të komandës armike dhe rreth e rrotull qëndronin gjermanë me automatikë, ndërsa ballistët kontrollonin shtëpitë për të vjedhur sende me vlerë. Persefoninë e sollën të lidhur te rripi në mes të fshatit. Burrat me grushte e nofulla të shtrënguara, shikonin me urrejtje tradhtarët, gratë me sy të përlotur vështronin nga bija e tyre, e cila qëndronte trimëreshë...

Persefoni iu kthye xhelatëve: “Në vend të fustanit, unë vësha pantallonat, mbi flokët e prera vura kapelën me yllin e kuq, në vend të kërrabës rrëmbeva pushkën e dola malit së bashku me mijëra shoqe e shokë të tjerë që luftojnë për liri. Ky nuk është turp, por nder, nder i madh”. Dhe duke iu drejtuar popullit tha: “Mos qani nëna, motra, vendi im s’mbetet bosh. Shokët do të ma marrin hakën. Ne do të fitojmë! Nuk vazhdoi dot më shumë, se iu hodhën armiqtë e ia zunë gojën. Në mbrëmje mes kolonës së gjatë gjermane e çuan në burg. Më 4 Korrik 1944, aty nga ora 9, makina i çoi të burgosurat në hetuesi. Persefonisë i kërkohej që me çdo kusht që ajo të firmoste deklaratën ku të deklaronte se hiqte dorë nga lufta. “Kam nënshkruar një herë, kapiten kur preva gërshetat, mora pushkën, veç jo me penë e bojë, po më gjak shokësh e shoqesh që bien për liri! Dhe e grisi deklaratën në sy të tij. Ai e kapi nga mjekra vajzën dhe nxori çakmakun, të cilin pasi e ndezi nisi t’i digte lëkurën e hollë të gushës!”. E varën në litar Persefoninë...

Në historikun e Brigadës VI Sulmuese, Persefoni Kokëdhima veçohet si një luftëtare e shquar dhe drejtuese e aftë. Mbi këto motive të heroizmit partizan, vajza e Qeparoit u shpall “Heroinë e Popullit”. Dy Heroinave, Persefoni Kokëdhimës e Bule Naipit, populli u këndoi këngë: “Dunavat e Palorto,/Ç’vajza keni rritur-o!” Ndërsa në filmin e bukur artistik shqiptar, “Ngadhënjim mbi vdekjen!”, trajtohet jeta e Bule Naipit dhe Persefoni Kokëdhimës. Filmi pati një sukses të jashtëzakonshëm në Kinë dhe është parë nga mbi 100 milion shikues. Gjithashtu, emri i heroinës Persefoni Kokëdhima, është vendosur në shkolla, rrugë dhe institucione të tjera publike.

“Heroina e Popullit”, Liri Gero, partizania dhe komandantja trime

Liri Gero, “Heroinë e Popullit”, lindi në vitin 1926 në qytetin e Fierit nga një familje e njohur, më pas, e lidhur e gjitha me Luftë Antifashiste Nacional Çlirimtare. Ajo ishte partizane në brigadën XVII Sulmuese, ku falë trimërisë si luftëtare, iu besuar detyra e komandantes së skuadrës, të cilën e kreu me përpikëri, derisa dha jetën e saj të re për lirinë..

...Atyre viteve të luftës, kur mbi Atdheun e tradhtuar e të mbuluar nga mjerimi rëndonte robëria, kur në zemrat e shqiptarëve vlonte revolta kundër pushtuesit, shumë nga banorët e lagjes Shkozë të qytetit të Fierit, e dinin se bashkë më të tjerët edhe vajza e dytë e Tili Geros, Liria, punonte ditë e natë për lëvizjen, se ishin yjet e punuar prej duarve të saj ato që skuqnin në bustinat partizane, se në gjirin e saj fshihehin letra që lajmëronin shokët për lëvizjet dhe planet e armikut, që sinjalizonin për aksione të guximshme, apo që përmbanin fjalë të dala nga zemra, letra që mbanin mbishkrimin “V.E.L.P”, që i fuste datën armikut. ...Vajza e re 15-vjeçare eci pa u trembur përmes rreziqeve, torturave pranë trekëmbëshave ku varëshin shokët e saj. Urrejtja për armikun dhe dashuria për Atdheun e popullin e kishin bërë të pathyer. Në moshën e saj, vajzat ëndërronin shokun e jetës, përgatisnin pajën e nusërisë. Dhe ajo përgatiti pajën: yje të kuq, fanella për shokët, çorape për këmbët e ngjira...Ishin kohë heroike kur dashuria për Shqipërinë s’shprehej në hartime, por në luftë për liri dhe, në këtë fushë, Liria zgjodhi detyrën më të vështirë, atë të punës ilegale nën hundën e armikut: italianit, gjermanit, ballistit e gjithë bandës së spiunëve, që nuhasnin më keq se zagarët. Luftonin kështu atëherë, kur dita plot shqetësime e ankth, dukej më e gjatë se një shekull, kur kontrolli pritej nga çasti në çast dhe, kur një fletë komunikate e zënë në xhep, ishte aktakuza e dënimit me vdekje. ...Një ditë Liri Geros shokët i thanë: “Shko te motra në brigadën partizane. Qëndrimi yt është i pamundur në qytet. Je diktuar. Do të të arrestojnë”. ...Iku me një pajton, ashtu siç ikin vajzat nga shtëpia prindërore, e veshur nure, me një buqete lulesh në duar. E përcollën me këngë e dajre. Kundrejt saj ishte dhe një djalosh veshur bukur: “dhëndri”. Kështu, me “çiftin e martuar”, pajtoni kaloi postblloqet fashiste. -Che bella ragazza!” (Ç’ vajzë e bukur!) - thonë rojet. Ku ta dinin ata se më vonë, mbi kokë të tyre do të binin plumbat e pushkës së saj. S’mund ta merrnin me mend se ishte ajo, ilegalja e rrezikshme, që kushedi sa herë e kishin kontrolluar e për të cilën ishte dhënë edhe urdhrin i arrestimit, se ajo “nuse” do të komandonte një skuadër luftëtarësh partizanë të Brigadës XVI Sulmuese. Dy motrat partizane mezi prisnin ta takonin njëra-tjetrën, por aksionet luftarake s’i lejonin. Në pritje të takimit, ato s’u panë kurrë. Në Tetor të 1944-s batalioni ku bënte pjesë Liria, ishte vendosur buzë një xhadeje. Pritej një autokolonë gjermane. S’vanoi shumë dhe u duk një varg i gjatë makinash të shoqëruara nga 5 tanke e autoblanda. Partizanët e batalionit II hapën zjarr. Lufta u ndez e rreptë. Makinat morën flakë. Të goditur papritur, nazistët hidheshin nga makinat, rendnin pas tankeve e autobлиндave që të mbroheshin e të zinin pozicion, por plumbat e armëve të partizanëve i ndiqnin kudo. Qëllonte dhe Liria në krye të skuadrës së saj. Qëllonte me tërbim mbi okupatorët, duke u hakmarrë për krimet që kishin bërë, qëllonte dhe për djegien e shtëpisë së saj në Fier, për burgosjen e babait, qëllonte... U plagos disa herë, por nuk u mposht...Luftoi gjersa mbeti pa ndjenja. Mbi 20 automjete dhe autoblanda u dogjën, 35 ushtarë armiq u vranë dhe shumë u plagosën. 12 partizanë shkruan një epope të lavdishme me gjakun e tyre. Ndër ta ishte dhe Liria. Atë e zunë dëshat naziste dhe, pasi e spërkatën me benzinë, i vunë zjarrin. Dora gjakatare e armikut barbar dogji trupin e vajzës së re, bijes së Shkozës e të tërë Fierit, bijes së popullit, por idealet, dëshirat, ëndrrat që çelën gjatë stinës së luftës në shpirtin e saj, s’do të vyshken kurrë. ... Heroina e Popullit Liri Gero, ra dëshmore në tetor të vitit 1944.



Liri Gero, Heroinë e Popullit

Liri Gero, Heroinë e Popullit

Liri Gero, Heroinë e Popullit

Liri Gero, Heroinë e Popullit

Liri Gero, Heroinë e Popullit

Liri Gero, Heroinë e Popullit

Liri Gero, Heroinë e Popullit

Liri Gero, Heroinë e Popullit

Liri Gero, Heroinë e Popullit

Liri Gero, Heroinë e Popullit

Liri Gero, Heroinë e Popullit

Liri Gero, Heroinë e Popullit

Liri Gero, Heroinë e Popullit

Liri Gero, Heroinë e Popullit

Liri Gero, Heroinë e Popullit

Liri Gero, Heroinë e Popullit

Liri Gero, Heroinë e Popullit

Liri Gero, Heroinë e Popullit

Liri Gero, Heroinë e Popullit

Liri Gero, Heroinë e Popullit

Liri Gero, Heroinë e Popullit

Liri Gero, Heroinë e Popullit

Liri Gero, Heroinë e Popullit

Liri Gero, Heroinë e Popullit

Liri Gero, Heroinë e Popullit

Liri Gero, Heroinë e Popullit

Liri Gero, Heroinë e Popullit

Liri Gero, Heroinë e Popullit

Liri Gero, Heroinë e Popullit

Liri Gero, Heroinë e Popullit

Liri Gero, Heroinë e Popullit

Liri Gero, Heroinë e Popullit

Liri Gero, Heroinë e Popullit

Liri Gero, Heroinë e Popullit

Liri Gero, Heroinë e Popullit

Liri Gero, Heroinë e Popullit

Liri Gero, Heroinë e Popullit

Liri Gero, Heroinë e Popullit

Liri Gero, Heroinë e Popullit

Liri Gero, Heroinë e Popullit

Liri Gero, Heroinë e Popullit

Liri Gero, Heroinë e Popullit

Liri Gero, Heroinë e Popullit

Liri Gero, Heroinë e Popullit

Liri Gero, Heroinë e Popullit

Liri Gero, Heroinë e Popullit

Liri Gero, Heroinë e Popullit

Liri Gero, Heroinë e Popullit

Liri Gero, Heroinë e Popullit

Liri Gero, Heroinë e Popullit

Liri Gero, Heroinë e Popullit

Liri Gero, Heroinë e Popullit

PROF. ASOC. DR. ZAHO GOLEMI

Në vijim të ciklit të shkrimeve “Kafshët luftëtare si dhe njerëzit”, po sjellim historinë e ariut-ushtar, Wojtekut që u rekrutua ushtar për frontin e luftës dhe u bë i famshëm për njerëzimin. Në betejat e Luftës së Dytë Botërore, njerëzimi vijonte të “fronte” të bëheshin bashkë edhe kafshët në këtë ndërmarrje të “domosdoshme” të njerëzimit, si pjesëmarrës në artin e shkatërrimit. Luftërat, njerëzit dhe kafshët janë shndërruar në binjakë historikë, sepse shoqëritë njerëzore janë bashkëshoqëruar shekujve të përgjakshëm edhe nga kafshët. Kafshët janë gjithashtu shërbëtore të njerëzimit në situatë paqësore, por dhe në situatë luftarake. Kafshët janë përfshirë në luftëra bashkë me njerëzit, veçanërisht në kohët parahistorike e deri në ditët tona. Elefantët, devetë, kuajt, qentë, arinjtë, delfinët...pëllumbat janë bërë padashur “luftëtarë”, janë “rekrutuar”, kanë luftuar bashkë me njerëzit, kanë qenë në front dhe në prapavijë. Në përballjet luftarake të përgjakshme nëpër shekuj kafshët e luftës janë vrarë, plagosur e ngordhur ndoshta më shumë se të zotët e tyre. Por kafshët që kanë mbijetuar luftërave janë vlerësuar si të zotët e tyre, janë nderuar, respektuar, dekoruar me urdhra e medalje lufte, kanë marrë grada ushtarake ndoshta më shumë se të zotët. Për ta janë bërë filma e vepra letrare, janë ngritur monumente, kanë hyrë në dokumentacionin historik si dhe janë përjetësuar në kujtesën e njerëzimit. Në rrugëtimin luftarak në të gjithë luftërat, përfshi dy luftërat botërore nuk munguan dhe kafshët besnike të njerëzimit ku përveç qenit dhe kalit, kafshë-egërsira si ariu, u rritën mes njerëzve dhe imitonin ata sikurse ishte ariu “Wojtek”, që u kthye në një ushtar besnik dhe i famshëm që i shpëtoi betejave të përgjakshme dhe u kthye triumfator e fitimtar nga lufta. Ngjarja zë fill më 8 prillin e vitit 1942, kur një grup robërish polakë, që po transportoheshin nga Siberia përmes Iranit në Lindjen e Mesme drejt Palestinës dhe më tej Aleksandrisë së Egjiptit. Edhe pse kanë kaluar dekada që nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore, një luftë e sprovë nga më të vështirat të njerëzimit në shekullin e njëzetë, lexuesit mbeten të interesuar të dinë gjithçka për betejat e saj, heronjtë, të rënë, taktikat, strategjitë, planet, veprimtaritë, ngjarjet, por dhe për heronjtë e mbijetuar. Kjo luftë ishte e mbushur me gjithçka, me gjak, dhimbje e lot, me gëzime dhe shpresë, me viktima të rënda dhe plot të papitura, me operacione unike ushtarake, por që kishte në front edhe kafshë të buta dhe të egra lufte si dhe ushtarë të pazakontë, sikurse ishte ariu ushtar, Wojtek. Ai ishte ushtari më i pazakontë i Korpusit të dytë polak, që u rekrutua në Iran, dhe kaloi në Siri, Palestinë, Egjipt e Itali. Në Aleksandri u regjistrua zyrtarisht ushtar në repartin e furnizimit të trupave të artilerisë dhe së bashku me vëllezërit e tij ushtarë që për dy vjet ishte “nën armë”, që u rrit, kalit, u mësua në luftë deri sa preku shijen e fitorës. Jeta dhe vepra e një ushtari special nuk ishte as mit dhe as legjendë por një e vërtetë lufte, një fakt që qarkulloi gjatë, midis forcave aleate. Ariu i famshëm Wojtek, u bë një lloj “djalë regimental” i Ushtresë Polake, edhe pse arinjtë janë veçanërisht të rrezikshëm në adolehscencën e “kthesës”, kur fillojnë të mashtrojnë, binden dhe mund të sulmojnë papritur. Por Wojtek kishte trajnerë të shkëlqyer që ariun e trajtuan si njeri dhe jo si ari. Wojtek kopjoi dhe imitoi ushtarët e tjerë, në të gjitha veprimet e njerëzve, edhe duke marshuar përkrah tyre në këmbët e tij të pasme, sepse i pa ata të bënin këtë. Ngjarja e parë që e bëri të njohur ishte kur ushtari Wojtek neutralizoi një spiun të rrezikshëm nazist gjerman arab, që u detyrua nga ariu të ngjitej në një palmë, duke u frikësuar nga sulmi i shpejtë i një ushtari trim siç ishte Wojteku. Ndërkohë që gjatë betejave të ashpra të aleatëve në Itali, Wojtek tregoi guxim, duke transportuar municion artilerie direkt në vijën e parë të frontit. Nën zjarrin e kryqëzuar të forcave gjermane, ai nuk u largua kurrë nga pozicioni i luftimit dhe në këtë mënyrë i ndihmoi shokët e tij të përmbushnin urdhrin luftarak. E pazakonta, në këtë histori, është se ndër mijëra luftëtarë frontit, në frontet e Luftës së Dytë Botërore, ushtari Wojtek ishte thjesht një ari, i gjetur në Iran dhe i marrë me pagesë nga ushtarët e ushtresë polake të Korpusit II. Në betejën e Montekasinos në Itali, ai ndihmoi gjuajtësit polakë të shkarkonin kutitë e municioneve dhe madje solli predha gjatë betejës, të cilat përjetësuam emrin e tij. Fiziku i fuqishëm i Wojteku u shfrytëzua nga “shokët” e tij ushtarë në kohë lufte. Faktikisht gjithë ushtarët që u njohën, bënë shoqëri dhe luftuan me Wojtekun, nuk i harruan kurrë luftimet në fushatat luftarake, shokun e tyre që e gjetën dyvjeçar dhe për dy vjet nga disa kilogramë në fund të luftës u bë një ari luftëtar i vërtetë me peshë mbi dyqind kg. Historia si dëshmitare ka hedhur dritë dhe ka ndriçuar rrugët e kujtesës si për njerëzit ashtu edhe për kafshët që luftuan në betejat e historisë dhe një prej “ushtarëve” pa atdhe është padyshim ariu Wojtek.

“Rekrutimi” i ariut Wojtek si ushtar i betejave i barabartë me njerëzit

Në një stacion hekurudhor në provincën Hamadan të Iran, më 8.4.1942, ushtarët polakë takuan një djalë të ri iranian, i cili kishte gjetur një këlysh ariu, nëna e të cilit ishte qëlluar nga gjuetarët. Një nga refugjatët civilë të luftës, që ishte në mesin e tyre, tetëmbëdhjetë vjeçarja Irena/Inka Bokiewicz, stërmbesa e gjeneralit Boleslaw Wieniawa Dlugoszowski, e kishte pëlqyer këtë këlysh ariu dhe iu lut togerit Anatol Tarnowiecki të blinte ariun e vogël, si të ishte një kukull. Blerja ishte thjesht me disa konserva mishi dhe kanoçe me ushqim të konservuar dhe pak para që ushtarët polakë e joshën djaloshin iranian të qytetit të Hamadanit. Karriera e pazakonshme ushtarake e Wojtekut fillonte atje, në malet Alborz, në veri të Iranit në provincën e Hamadanit. Në Iran polakët u vendosën në një kamp refugjatësh të krijuar pranë Teheranit, kryesisht nën kujdesin e Irenës dhe në muajin gusht 1942, ariu u dhurua Kompanisë së 2-të të Transportit, e cila më vonë u bë Kompania e XXII e Furnizimit të Artilerisë. Këlyshi i ariut, fillimisht pa emër, ishte shumë i vogël dhe nuk mund të përtypte as ushqimin vetë, prandaj ushtarët filluan ta ushqenin atë me qumësht lope nga një thithë e improvizuar e bërë nga një shishe. Këlyshit të vogël i gjetën edhe një emër. E emërtuan në polonisht “Wojtek”, që është pseudonimi, forma zvogëluese i “Wojciech” ose “Luftëtar i lumtur/i buzëqeshur”, një emërtim i vjetër, ende i zakonshëm në Poloni. Ariu i vogël filloi të rritet dita ditës dhe ishte i kudogjendur në kompaninë e furnizimit të artilerisë, duke u regjistruar zyrtarisht në përbërjen e saj, por dhe i adhuruari dhe atraksion për ushtarët dhe civilët, që e ushqenin, ndërsa në këmbim, ai forconte moralin e tyre. “Pritja miqësore për ushtarët që ktheheshin, shpeshherë tejet të lodhur, nga ana e Wojteku ishte për ne një moment i rëndësishëm relaksues”, -kujtonte veterani polak Wojciek Narebski. në një intervistë të vitit 2011. Ushtarët polakë kishin vuajtur shumë në kampet sovjetike të internimit, shumë larg familjeve dhe miqve në kushte tejet të vështira. Wojteku ishte kthyer në burimin e vetëm të gëzimit. Kur Korpusi i Dytë u transferua nga Irani në Palestinë, më pas në Afrikën e Veriut dhe prej andej më vonë në Itali, edhe Wojtek bëri të gjithë udhëtimin me ushtarët polakë. Ai nuk e dinte se ishte bashkuar me aleatët fitimtarë të luftës.

Wojtek ishte rritur ndjeshëm, dhe ishte pjesë e gëzimeve “njerëzore”, i privilegjuar të ushqejeje me fruta, marmelatë, mjaltë, shurup, për sjellje të mirë e shpërblenin



me birrë dhe e kishin mësuar të pinte dhe duhan. Bile duhanin e kërkonte duke u rënë në sup me putër ushtarëve që kishte shok. Duhanin e shoqëronte mëngjeseve edhe me kafe ashtu sikurse ushtarët e tjerë të repartit. Ushtarët ishin bërë trajnerë unikë, sepse nën udhëheqjen e tyre, ariu mësoi të përshëndeste të moshuarit e tij dhe të bënte mundje me njerëzit pa u shkakuar atyre ndonjë dëm, duke e bërë ariun që “të njihte shakanë” dhe të dinte kufijtë e dhimbjes tek njerëzit. Ai “përleshej” si me shaka me ushtarët, që shkaktonin ilaritet dhe gëzim. Në kampet fushore luftarake të kompanisë ndërtohej gjithmonë një kabinë e veçantë, por ushtari ari, nuk e pëlqente vetminë dhe pothuajse gjithmonë e kalonte natën me ushtarët në tenda.

Nga Aleksandria e Egjiptit drejt

betejave të reja në Itali përmes Mesdheut

Trupa ushtarake polake ishte duke u transportuar nga Egjipti përmes Mesdheut drejt Italisë. Ka qenë fillimi i vitit 1944. Por përpara se të imbarkoheshin në anije zallamahia dhe rrëmujua ushtarake ishte diçka e pashmangshme. Zyrtarët e portit në Aleksandri refuzuan që të lejojnë ariun e egër që të hipë në anije, duke theksuar se vetëm ushtarët lejoheshin të hipnin në anije. Por peripecia u mbyll shpejt me regjistrimin e Wojtekut zyrtarisht si ushtar. Kompania e 22-të e Artilerisë po ndihmonte të hipte në anije një “shokun” e tyre ushtar. Autoriteti portual më në fund i dha leje të shkonte bashkë me “shokët”, edhe një ari luftëtar i regjistruar, që prej dy vjetësh, bënte atë që quhej “jetë kazerne”. Ishte dhe mbeti miku i tyre i ri i ushtarëve polakë që vinin nga Irani, një këlysh që kishte hedhur shtat dhe ishte pjesë e formacionit luftarak, gjithmonë i pandashëm në formacionet luftarake. Prej dy vjetësh, kjo genie specifike, tepër e dashur me ushtarët kishte jetuar bashkë me ta, kishte bërë jetë kazerne. Ishte mësuar të jetonte, të flinte, të hante, të lahej, të luftonte me ushtarët, me disiplinë dhe me rresht. Ishte e habitshme se si ariu Wojtek, ishte bërë në ushtarin më të disiplinuar të kazermës ushtarake. Ushtarët polakë në këtë pikë të largët të atdheut të tyre ishin bërë aleatë me francezë e britanikë në vitin 1941, të burgosurit u liruan dhe u drejtuan në jug për të formuar një ushtri tyre. Fakt është se disa përfunduan më në jug dhe bashkë me ta edhe ariu “Wojtek”. Ai ishte bërë familje për ushtarët. Ariu ushtar u bë shok e kaluar shokëve në luftë. Ai u falte gëzim dhe lumturi edhe në ato çaste të përgjakshme lufte. Për ta hipur në anije që të shkonin drejt Italisë çuan listat në kapitaneri dhe e kishin regjistruar me emrin “ushtari Wojtek”. Ky ushtar special nuk kishte të paguar, por paguhej me dyfishin e racionit të ushqimit, sepse pesha e tij shpejt e kapërcëu të dyqind kg. Në situata jo të zakonshme kur cigaret nuk mund t’i pinte u mësua t’i hante, ndërkohë që i pëlqente kafeja, ëmbëlsirat dhe birra që i ofronin ushtarët. Wojtek u bë shpejt edhe gaztor i ushtarëve, luante futboll me “shokët” me kambale. Frutat sidomos portokallet i hidhte si granata, më shumë në distancë se çdo ushtar tjetër. Pëlqente të ishte shoqërues i arkave me municion në makinat e transportit të municionit, që në një farë mënyre u bë “profesioni” i tij. Uji ishte dobësia e tij. Nuk priste të “hiqte rrobat” sikurse ushtarët e tjerë sepse në kohë të nxehtë futej në ujë si një notar i klasit të lartë. Në betejën e Montekasinos, Wojtek u bë një ndër trasportuesit mjesh të rori si predha mbajtës si dhe dinte t’i përdorte me kujdes maksimal predhat e artilerisë. Veprimet e këtij luftëtarit të spikatur në luftë bënë që regjimenti i artilerisë të ndryshonte simbolikën e tij dhe ta shndërronte në një ari me një predhë në krah. Pas betejës në Itali, dhe në mbarim të luftës ariu luftëtar u gradua “komandant” dhe pas luftës edhe u dekorua, por beteja e Montekasinos është stacioni luftarak që meriton pak më shumë vëmendje.

“Ushtari Wojtek” - luftëtar i denjë

i frontit dhe hero i betejës së Montekasinos

Nuk ishte një ushtar i thjeshtë, por një luftëtar llogoresh, një ari simpatik që u bë i famshëm në Luftën e Dytë Botërore. Fat i egër i luftës i çoi një pjesë të ushtarëve polakë në drejtim të paparashikueshëm. Ushtarët polakë që kur takuan ariun Wojtek në Iran, kishin me vete një copëz bekim dhe zemrat e ushtarëve ishin bërë njësh përjetësisht me këtë shok betejash nga më të veçantët e jetës së tyre. Ai ishte një ari i çuditshëm e simpatik, që imitonte gjithçka. Bëhej gati për rresht dhe për front sikurse gjithë ushtarët e tjerë, rreshtoheshin në vendin e vet, përshëndeste ushtarakisht, merrte drejtqëndrim në këmbë si njerëzit, lahej me ushtarët, shkonte në mensë, luante, bënte mundje, argëtohej dhe argëtonte ushtarët. Duket si e pabesueshme por cigaret ia mësuan ushtarët dhe ia ndiznin po ata si të ishte një efendi i vërtetë. Që kur ishte “rekrutuar” ishte përshartur plotësisht me të gjitha rregullat ushtarake. Wojteku e pajisën me librezë ushtarake, me numër matrikullimi, numrin serial të ushtarit, si dhe krejt rankimin e plotë të një luftëtarit në luftë. Në dokumentacionin arkivor rezultojnë edhe gjeneralitetet për “ushtarin Wojtek”. Askush nuk mund ta nënvleftësonte një ushtar të regjistruar, që qëndronte gjithmonë mes dy ushtarëve të tjerë. Gjatësia e tij 182 cm, në fillim të vitit 1944 si dhe pesha prej 90 kg plotësonte kriteret e një luftëtarit madhor kur ishte në Itali në betejën e Montekasinos. Kujtimet e ushtarëve polakë nuk e kanë lënë mister zbarkimin në tokën italiane të ushtarit Wojtek. Në mesin e shkurtit të vitit 1944, marshali britanik, Bernard Montgomery, në portin e Napolit, për të ndihmuar në procedimin e një njësie të ushtarëve polakë, e cila sapo kishte arritur me anije nga porti egjiptian i Aleksandrisë, për të mbështetur ushtarët britanikë në luftën kundër njësive gjermane dhe italiane. Kontrolli i listave të ekuipazhit dhe bisedat me ushtarët e sapo arritur për anglezët ndeshën në një befasi: vetëm një person,

ushtari Wojtek ishte zhdukur pa gjurmë sepse kishte “braktisur intervistën”, por dhe nuk i përgjigjej “apelit ushtarak”. Wojteku nuk po paraqitej. Një kolonel iu përgjigj duke qeshur: “Ai kupton vetëm gjuhën polake dhe atë perse”. Ishte pjesëtari më i popullarizuar i repartit, që u bindej vetëm bashkëluftëtarëve të tij. Ka qenë 17 maj 1944, kur forcat aleate pas katër 4 muajsh luftimesh të ashpra (17.1.1944 deri më 17.5.1944), depërtojnë në vijën mbrojtëse të linjës gjermane Gustav në Itali, ku morën Romën. Beteja e Montekasinos ishte një ndër betejat e ashpra dhe më të përgjakshme të Luftës së Dytë Botërore, beteja që kishte edhe një luftëtar të ndërkombëtarizuar, ushtarin-ari, Wojtekun. Ndërkohë që për Wojtekun beteja e Montekasinos ishte “Pagëzimi i zjarrit” sepse kur ushtarët shkarkonin kamionët me predha, Wojteku u shndërrua në krye ushtar, i disiplinuar dhe i zotë, që lëvizja e tij ishte plot produktivitet nga prapavija në frontin e luftës. Në shenjë mirënjohjeje, kompania e 22-të zgjodhi si emblemë të re siluetën e një ariu që mban një predhë në putrat e tij, që ruhet edhe sot e kësaj dite me këtë simbolikë gati tetëdhjetë vjeçare. Në këtë betejë, ndër më të përgjakshmet e luftës, aleatët perëndimorë, gjatë së cilës amerikanët dhe britanikët depërtuan përmes vijës mbrojtëse të linjës gjermane Gustav dhe morën Romën, patën humbje të konsiderueshme: SHBA dhe aleatët më shumë se 55 mijë njerëz; ndërsa nazistët gjermanë rreth 20 mijë ushtarë. Të katër betejat e Montekasinos drejtoheshin për aleatët perëndimorë nga gjeneral Harold Aleksandër, Mark Klark dhe Oliver Lee, ku në luftime ishin Armata e Pestë e SHBA-ve dhe Armata e Tetë Britanike, ndërsa gjermanët drejtoheshin nga mareshal Albert Kesselring, kolonel gjeneral Heinrich von Vietinghoff, që mbronin vijën e përballjes me armatën e 10-të gjermane. Fakt është se gjatë Luftës së Dytë Botërore, ushtritë aleate pushtuan nga jugu dhe u përpoqn të shtynjë drejt veriut dhe t’i detyrojnë gjermanët të largohen nga Italia. Montekasino besoej të ishte një strehë strategjike për trupat gjermane, dhe për këtë u bombardua në një beteje të zgjatur nga avionët aleatë, që shkatërruan plotësisht manastirin, që në fakt ishte një strehë për civilët. Beteja e Montekasinos ishte një pikë kthese në luftë, por me një kosto jashtëzakonisht të lartë, por dhe humbje tragjike ndaj trashëgimisë kulturore, përfshirë dorëshkrime të paçmuara. Edhe pse u rindërtua sipas planit origjinal u rihap nga Papa VI më 1964, dy dekada pas lufte. Abacia e Montekasinos ndodhet 130 km në jug të Romës dhe 100 km në veri të Napolit, në malin mbi qytetin e Kasinos në rajonin jugor të Lacios. Gjithë treva vendase dhe jo vetëm mësoi se për marrjen e Montekasinos luftonte edhe një ari. Në të dy anët e frontit ka hyrë në histori ushtari-ari Wojteku, që mbante lehtësisht arkat e municionit dhe i stivonte ato në makina si të ishte njeri. Arkat e municionit që kërkonin katër ushtarë, Wojteku i mbante i vetëm, për këtë edhe u gradua “tetar”, “rreshter”, “kapter” dhe ngjiti shkallët më të larta në karrierë. Wojteku i vogël i dikurshëm në përfundim të luftës u rrit dhe u bë ari i madh, 1.82 cm i gjatë dhe peshonte mbi dyqind kilogramë. Ushtarët polakë e shfrytëzuan për fuqinë e tij si bartës i arkave të mbushura përplot me predha/mina të rënda të mortajave. Asnjë predhë/minë nuk i binte nga duart/putrat gjatë transportimit të municioneve, duke u kthyer kështu një luftëtar i denjë i frontit, rreshtuar me fitimtarët e luftës. Kur Wojteku mbante arka municioni “e ngritën në detyrë”, i akorduan gradat ushtarake “si shërbërë” në supet e ushtarit Wojtek, ndërsa njësia e tij luftonte në fushatën e Italisë bashkë me aleatët anglezë dhe amerikanë. Nuk dihet nëse Wojtek arriti të marrë gradën gjeneral apo jo, me shumë mundësi jo, pasi nuk rezulton në asnjë regjistër që Wojtek të ketë qenë edhe “shef shtabi i përgjithshëm” ndonjëherë!

Ariu Wojtek - një luftëtar heroik, më i graduari, më i dekoruari dhe më i njohuri i arinjve pjesëmarrës në luftë në historinë e njerëzimit

Në vitin 1945, njësitë ushtarake fituese të LIIB, në pamundësi për ta kthyer ushtarin e jashtëzakonshëm në atdheun e tyre, u dërguan në Britaninë e Madhe, ku u shpërndanë në shtëpitë e tyre. Wojtek u transportua në Berwickshire, Skoci, me pjesën tjetër të kompanisë së 22-të të furnizimeve. Ata u stacionuan në aeroportin Winfield në Farm Sunwick, afër fshatit Hutton, Skocia Borders. Wojtek shpejt u bë i njohur në mesin e civilëve vendas dhe të shtypit, dhe Shoqata Polako-Skoceze e bëri ariun luftëtar një anëtar nderi të kësaj shoqate. Edhe pse Wojteku nuk kishte shtëpi, ushtarët u kujdesën për “shtëpinë e tij të re” më 15 nëntor 1947 në kopshtin zoologjik të Edinburgut në Skoci. Në Edinburg, Wojteku u bë një mjeshër në punët e shtëpisë dhe preferencat e tij ndryshuan. U përshat me kohën e paqes. Tashmë nuk do të jetonte më si në kushte lufte. Ai tani hante sikurse njerëzit gjalpë reçel e mjaltë. Merrte pjesë në gjitha aktivitetet veçanërisht për fëmijë, duke u bërë aktiv në veprimtaritë e fëmijëve. Wojteku e bëri të njohur edhe kopshtin zoologjik të Edinburgut, ku kaloi pjesën tjetër të jetës së tij, i vizituar shpesh nga gazetarë dhe ish-ushtarë polakë, disa prej të cilëve i hidhnin cigare për të ngrënë, siç bëri gjatë kohës së tij në ushtri. Vëmendja e medias kontribuoi në popullaritetin e madh të Wojteku dhe për këtë Ai ishte një mysafir i shpeshtë në programin Blue Peter për fëmijë të televizionit BBC. Historia e Ushtarit Wojtek është bërë objekt filmash, librash, tregimesh si dhe ka shtatë statuja në Poloni dhe në Britani, ka një memorial në Britani dhe në Kanada. Shtëpia e tij e fundit ka qenë në kopshtin e Edinburgut në një kopsht zoologjik skocez. Këtu iu shtuan shokët dhe vizitorët. Ishte bërë i famshëm. Rreth vitit 1958 në Poloni, për një kohë të shkurtr filloi një fushatë e vërtetë për “kthimin” e Wojtek në “vendlindjen” e shokëve të tij ushtarë, edhe pse ariu nuk e vizitoi kurrë në fakt atdheun e miqve të tij polakë. Edhe pse kopshti zoologjik i Edinburgut deklaroi se ishte gati të transferonte ushtarin Wojtek, autoritetet polake nuk e miratuan transferimin për shkaqe “politike”, sepse ushtarët miq të ariut ishin kundërshtarë të vendosur të regjimit politik socialist të vendosur në Poloni, prandaj edhe përgjigjja ishte: “refuzim kategorik”. Në Edinburg të Skocisë është përkujtuar Wojteku me një monument në një nga sheshet e qytetit, për ushtarin e pazakontë të Luftës së Dytë Botërore, për ushtarin trim Wojtek. Ish-shokët e tij polakë, por më tej edhe britanikë, dhe jo vetëm, nuk e lanë kurrë vetëm, ndërsa në dhjetor të vitit 1963 kur ishte 22 vjeç, që peshonte rreth pesëqind kg. Njoftimi për vdekjen e tij ishte i klasës së fisnikërisë njerëzore: “Me qëqardhje ju njoftojmë se ka ndërruar jetë një ushtar i famshëm polak”. Ushtarët polakë dhe jo vetëm kishin humbur një shok të betejave luftarake, një ari-ushtar, një ushtar të lumtur, që depërtoi në historinë e njerëzve dhe që askush nuk u shpreh “ngordhi”, por “ndërroi jetë”, sepse ishte një fitues në luftë, iu njohën meritat, iu dhanë gradat e ofiqet, u nderua e respektua si rrallë ndonjë luftëtar heroik. Wojteku i dha emër nënrepartit ushtarak ku shërbeu për arsye se u etiketua si “ushtari predha mbajtës më i mirë për predhat e artilerisë” dhe për këtë arsye nënrepartit të tij dhe për nder të tij i bënë një emblemë të re, që simbolizonte një ari me një predhë në putrat e tij dhe kjo ishte “Emblema e Kompanisë së 22-të të Furnizimit të Artilerisë” të polakëve. Është fakt se Wojtek u shndërrua në simbol të solidaritetit mes Polonisë dhe Skocisë, që vijon të jetojë në kujtesën e popujve të të dy vendeve.

Trembëdhjetë vjet më parë, më 2009, Parlamenti i Skocisë organizoi një pritje në nderim të ushtarit Wojtek, sepse historia e tij është unike, ndërkohë që rrefimet me tregime vijnë, edhe me libra dhe në film. Statuja e bronzit, në qendër të Edinburgut, e nëntorit 2015, e bën ariun Wojtek të vendosur në kujtesën e njerëzimit. Në vitin 2011, Will Hood, regjisori i filmit dokumentar, “Ariu Wojtek që shkoi në luftë”, u pyet se çfarë e ka ngazëllyer në rrefimin dokumentar për këtë ari-luftëtar. “Fakti se ai vetë ka menduar se është njeri, ngre disa pyetje interesante për atë se çfarë është të jesh njeri?!”,- u përgjigj rregjisori Will Hood.

Një ditë e zakonshme stërvitje e Forcave Speciale

